Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

NEDELNI LIST
FLETORE E PERJAVESHME

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 96 din
— 6 muej 48 —
— 3 muej 24 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 116 | PRISHTINE, 31 Maj 1948 | Çmimi 2 dinarë

Vendim i KQ të PKJ mbi thirrjen e Kongresit të V-të të Partis Komuniste te Jugosllavis

Ne mbledhjen e vet te 20 majit 1948 Plenumi i KQ te PKJ vendosi:

I

Kongresi i V-të i PKJ thirret per daten 21 korrik v. 1948 ne Beograd.

II

Plenumi cakton ket rend dit' te Kongresit:

1) Referati politik i KQ te PKJ: a) Zhvillimi dhe lufta e PKJ; b) Roli i PKJ ne transformimin revolucjonar te Jugosllavis; c) Referati mbi punen e KQ te PKJ, — referues shoku Josip Broz—Tito;

2) Referat mbi punen organizative—te Partis te PKJ,—referues shoku A. Rankoviq;

3) Referat mbi agitacjonin e propaganden,—referues shoku M. Gjillas

4) Referat mbi poziten nderkombetare e te mbrendshme te Jugosllavis dhe lufta e PKJ per ndertimin e socjalizmit. — referues shoku E. Kardelj;

5) Referat mbi ndertimin e ekonomis socjaliste te Jugosllavis, — referues shoku B. Kidrič;

6) Projekt—programi i PKJ, — referues shoku M. Pijade;

7) Projekt—statuti i PKJ — referues shoku B. Neshkoviq;

8) Zgjedhja e Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe Komisjonit Qendruer te Revizjonit.

III

Plenumi cakton ket ecuni ne zgjedhjen e delegatve per Kongresin e V-te:

Zgjidhet nji delegat per 200 antare.

Zgjedhja e delegatve bahet me vota te mshefta ne konferencat e rretheve, qyteteve, ase rejoneve.

Komunistat n'organizatat e Partis n'ushtri zgjedhin delegatet ne baze te te njajtave parime.

Beograd, 24 maj 1948

Telegram Komitetit Qendruer të Partis Komuniste të Jugosllavis

Te rinjte te rejat nga te gjitha anet e Vendit t'one, te cilet kane urdhe me ndertue Beogradin e Ri, u-mblo, dhen ne miting, per te kuvendue se si te pregatiten per pritjen e Kongresit te peste te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe si t'a shprehin ma se miri m i r n j o f t j e n dhe dashunin e tyne ndaj Partis s'one te lavdishme komuniste, e cila e udheheq aq heroikisht e aq urte luften e popujve t'one ne lufte e ne paqe.

Na konsiderojme se mirenjoftjen t'one ndaj Partis, dashunin t'one te madhe ndaj saje, vendosjen t'one per te shkue edhe tash e mbrapa mbas Partis, kudo qe te na prije, do t'a shprehim ma se miri tue i shtue perpjekjet t'ona ne te gjitha fushat e veprimtaris s'one. Prandaj kemi vendose, qe ne ndere te Kongresit te peste te Partis Komuniste te Jugosllavis t'organizojme garen, ne te cilen i ftojme te gjitha brigadat puntore te rinis ne te gjitha akcionet e punes me karakter federativ, republikan e lokal. Tue shprehe dashunin t'one te madhe ndaj Partis se lavdishme komuniste dhe besimin n'udheheqesin t'uej t'urte, brohorisim:

Rrnofte Partija e lavdishme Komuniste e Jugosllavis, garanci e te gjitha sukseseve dhe fitoreve t'ona! Rrnofte Komiteti Qendruer i Partis Komuniste te Jugosllavis me shokun Tito ne krye!

Beograd, me 26 maj 1948

Ndertuesat e Beogradit te Ri

SESJONI I DYTE I ZAKONSHEM I KESHILLIT POPULLUER KRAHINUER

U-aprovue njizanit Statuti i Krahines Autonome te Kosovë-Metohis në kuadrin e Republikes Popullore të Serbis

Me 23 te ketij mueji, filloi Sesjoni i Dyte i Keshillit t'one Populluer Krahinuer ne prani te 173 delegateve te zgjedhun nga keshillet popullore te Kosmetit. Sesjonin e hapi shoku Fadil Hoxha, kryetar'i Keshillit Populluer Krahinuer. U pershendeten dy delegatet e Kuvendit Populluer te Republikes Popullore te Serbis Prota Milan Smiljaniqi dhe Mehmet Hoxha. U-zgjodh kryesija e punes, me shokun Fadil Hoxha ne krye. Mbassi u-verifikuen fletautorizimet e keshilltareve te rij e u ba betimi prej tyne, Keshilli filloi punen simbas ketij rendi dite: Proponimi i Rregullores se punes se Keshillit Populluer Krahinuer te Krahines Autonome te Kosove-Metohis; proponimi i Statutit te Keshillit Populluer te KAKM; proponimi i buxhetit te KAKM per vitin 1948; proponimi i llogaris perfundimtare te vitit 1946; referat mbi punen e Keshillit Ekzekutiv te Keshillit Populluer Krahinuer te KAKM; proponim per ndryshime ne ndamjen administrative teritorjale te disa kshillavet te vendeve; proponim per plotesimin e Keshillit Ekzekutiv te Keshillit Populluer Krahinuer te KAKM dhe proponim per plotsimin e Gjyqit te Nalte Disiplinuer te Keshillit Populluer Krahinuer te KAKM.

Shoket Hivzi Sulejmani dhe Ymer Pula referuen ne lidhje me Rregulloren e Punes te Keshillit Krahinuer, e cila u-pranue njizanit prej te gjithve si ne hollesina ashtu edhe ne tanesi.

Mandej muer fjalen shoku Boshko Çakiq, i cili referoi ne lidhje me Projekt-Statutin e Krahines Autonome te Kosove-Metohis.

Statuti dëshmon se te gjitha fitoret e luftes shlirimtare te popujvet te Jugosllavis jane edhe pronë e shqiptarve-tha Boshko Čakiq

„Ky Statut, tha shoku Çakiq, konfirmon edhe nji here ate qe asht konfirmue me Konstitucjen e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Statutin e Republikes Popullore te Serbis, dmth te drejtat e autonomis te Krahines se Kosove-Metohis. Me dhanien e ketij Statuti caktohet definitivisht pozita e autonomis se Krahines s'one ne kuadrin e Republikes Popullore te Serbis. Te drejtat per autonomi te Krahines s'one, te cilat formulohen ne ket Statut, jane te drejta qe populli i kesaj Krahine i ka sigurue, i ka fitue c'ma perpara. Statuti i yne vetem konfirmon ate qe asht korre ne saje te luftes heroike nacional-çlirimtare te popujve t'one, me gjakun e bijvet ma te mire te te gjithe popujvet t'one, pra, dhe popujve te Krahines s'one. Ato jane rezultat i kesaj lufte çlirimtare dhe zgjidhjes se drejte te çashtjes kombtare ne Vendin t'one, nen udheheqjen e Partis se lavdishme Komuniste te Jugosllavis, me shokun Tito ne krye, me ate qe krijoi shtetin e ri, Republiken Federative Popullore te Jugosllavis, si komunitet vllaznuer te popujvet me te drejta te barabarta e ku pakicat kombtare gezojne te drejten e plote te zhvillimit te tyne te gjithaneshem".

"Te drejtat e konfirmueme ne ket Statut, vazhdoi shoku Boshko Çakiq, popujt e Krahines s'one i gezojne qysh nga çlirimi nga zgjedha e pushtuesavet fashista dhe trathtareve te mbrendshem. Ky Statut pra asht shprehja e plote e realitetit te gjalle." Me pruemjen e ketij Statuti, Keshilli Populluer Krahinuer, si perfaqesues i popullit te Kosmetit, i zgjedhun nga populli nder votime te lira, formulon definitivisht ne menyren juridike deshiren e çfaqun lirisht te popujvet te Krahines s'one per te jetue ne kuadrin e Republikes Popullore te Serbis. Dhe popujt t'one e kane pa me pune se te gjitha shpresat qe i kane pase me rastin e vendosjes se tyne te lire per te jetue ne kuadrin e Republikes Popullore ta Serbis - jane realizue plotsisht. Populli Serb na ka dhane pa da ndihmen vllaznore ne perpjekjet t'ona per likuidimin e mbrapambetunis se trashigueme nga koha e vjeter; per perparimin kultural dhe ekonomik te Krahines s'one, per permiresimin e gjithanshem te jetes se shtresave te gjana popullore te Kosmetit".

"Ky Statut, perfundoi shoku Çakiq, ka nji randesi te veçante per shqiptaret e Kosoves e Metohis. Ay verteton edhe nji here te drejtat e fitueme, pasqyron realitetin ku jane sigurue te gjitha kushtet pra edhe ato materjale, per zhvillimin e gjithanshem te shqiptarve te Kosmetit. Statuti deshmon kjartazi se te gjitha fitoret e luftes lavdiplote nacional-çlirimtare te popujvet te Jugosllavis, jane edhe prone e shqiptareve, mbassi ne themelin e tyne edhe ata i kane eshtnat dhe gjakun e bijvet te vet ma te mire - Ramizit, Eminit me shoke, qe kane luftue per liri krah per krah me popullin vlla serb dhe me te gjithe popujt e tjere vllazen t'atdheut t'one, per lirin dhe fatbardhsin e perbashket qe sot e gezojme bashkarisht ne Republiken t'one te dashtun Federative Popullore te Jugosllavis".

Statuti asht rezultat i vllaznimit dhe bashkimit te popujve t'one, farkue me luftes shlirimtare, nen udheheqjen e PKJ dhe shokut Tito-tha shoku Fadil Hoxha

Mandej muer fjalen shoku Fadil Hoxha, i cili theksoi se Statuti i Krahines s'one asht, perveç tjerash, rezultat i vllaznimit dhe bashkimit qe farkuen popujt e Krahines s'one nder vedi dhe me te gjithe popujt e tjere t'atdheut t'one, nen udheheqjen e PKJ dhe shokut Tito, mbas mesimevet te bijvet te vet ma te mire, Boros, Ramizit, Milladinit dhe se lufta çlirimtare qe kane ba popujt t'one kundra pushtuesave te poshtem fashista dhe veglave te tyne, trathtareve te mbrendshem, u-kunorzue me sukses te plote, me vendosjen e drejtesis se vertete shoqnore dhe barazis kombtare, te cilat zgjanohen dita dites ne saje te djerses qe derdhin bashkarisht popujt t'one ne punen per ndertimin socjalist t'atdheut t'one, dhe ma ne fund vueni ne dukje ndihmen e gjane e te ditperditshme qe jep Qeverija Federative e RFPJ dhe Qeverija Popullore e RP te Serbis, sidomos per luften kundra mbrapambetunis se shqiptarevet te Kosmetit dhe per zhvillimin e tyne te gjithanshem.

Shoku Kol Shiroka, tue fole per Statutin e Kosmetit vueni mire ne dukje parimin e bashkpunimit vllaznuer dhe te te drejtave te barabarta te popujvet te Krahines s'one dhe tha se zbatimi i ktij parimi ka qene deshire e kahershme edhe e shqiptareve, si te gjithe popujvet te tjere te Jugosllavis. Dhe tregoi disa shembuj nga rrethi i Rahovecit, e qe dishmojne se keto deshira per liri e drejtesi te vertete s'ka mujte me i zhgule nga zemra e popullit kurrfare terrori, as ay i regjimevet kundra popullore te Jugosllavis se vjeter, as terrori i zi i fashizmit gjakatar.

Ma ne fund shoku Shiroka theksoi, tue fole per në shqiptaret e Kosmetit, se te drejtat t'ona te barabarta nuk kufizohen vetem me zhvillimin kultural ne gjuhen t'one amtare, porse ato shprehen ne te gjitha fushat e jetes ekonomike, politike e shoqnore. Foli per jeten e puntorvet shqiptare te minieres Trepça, per sistemin e çmimevet te lidhuna etj. dhe tregoi se si n'atdheun t'one te lire permiresohen dita dites kushtet materjale te popullit t'one puntuer.

Te gjithe diskutuesat u-nderprene shum here me duertrokitje nga delegatet — perfaqesuesa te popullit.

Mandej u-kalue ne shqyrtimin si ne veçantina ashtu edhe ne tanesi te Projekt-Statutit, i cili u-pranue njizanit me duertrokitje.

-Nuk e kam vlla serbin ase ortodoksin që më rri atje n'Amerikë ase ku dij un, shpifë kundra atdheut e popujve t'onë,-vlla e kam atë që punon së bashku me mue per të miren e përbashkët te të gjithe popujvet t'one - tha Prota Smiljaniq

I pritun me duertrokitje te gjata, Nenkryetari i Presidiumit te Kuvendit te RP te Serbis Prota Milan Smiljaniq thekesoi se Statuti i Kosmetit nuk asht tjeter veçse formulimi ligjuer i atyne te drejtave qe popujt e Krahines s'one i kane korre me luften e vet krah per krah me te gjithe popujt e Jugosllavis.

Prota Smiljaniq u-zgjat ma teper ne çashtjen e vllaznimit dhe bashkimit: ndonji shqiptari te pavetedijshem mund t'i dukej si e çuditshme qe un, serb dhe pop; i jap gjithe ket randesi perforcimit edhe ma te madh te vllaznimit ne mes te serbvet dhe malazezeve te kesaj Krahine me shqiptaret, si dhe vllaznimit te tyne me popujt e tjere te Jugosllavis. Por un atij i them: Nuk e kam vlla serbin ase ortodoksin qe me rri atje n'Amerike ase ku dij un, lepine sahanat e imperjalizmit e shpife kundra atdheut e popujve t'one, — vlla e kam ate qe punon se bashku me mue per te miren e perbashket te te gjithe popujvet t'one, per ndertimin e lumnis s'one te perbashket. Dhe pamvarsisht nga feja ase kombesija e tij."

Tue fole mbi kushtet e ndryshme qe kerkon puna e jone e mbare, Prota Smiljaniq theksoi veçanerisht randesin e kontrollit dhe evidences se ditperditshme dhe si shembull qiti shokun Eduard Kardelj, i cili, „si nji astronom, qe me dyrbin e vet teleshikuese ndjeke levizjet e te gjithe trupave qiellore, vezhgon pada njerezit qe punojne ne sektoret e ndryeshem an' e kand atdheut t'one". Gjithashtu theksoi randesin e zhvillimit t'inisjatives se masave te gjana popullore nga poshte dhe ketu permendi nji frontist te mire ronin, Aleks Klariq, i cili vjel bashke me popullin e me 12 pende qe ngriti ne vendin e vet

(Vazhdon ne faqen e dyte)

Buxheti i ri i siguron Krahines s'one zhvillimin e matutjeshem ekonomik dhe kultural te parapame ne Planin pesvjeçar

Referenti i Keshillit per Financat, shoku Alush Gashi, paraqiti projekt-buxhetin e ri te Krahines s'one per vjetin 1948, dhe ne mes te tjerash tha:

Buxheti i Krahines Autonome te Kosove-Metohis, te cilin Keshilli Ekzekutiv Krahinuer ia parashtron Keshillit Popullor Krahinuer per shqyrtim, ka per detyre me sigurue financimin e te gjitha punimeve te vjetit te dyte te Planit pesvjeçar te Titos.

Buxheti i propozuem per vjetin 1948 nuk asht ma buxhet administrativ siç ka qene ma se forti deri tash, por ai asht, kryesisht, buxhet ekonomik. Nga te gjitha te dalunat e parapame ne buxhet, per vjetin 1948, ekonomis i takojne 216.060.166 dinare ase 34 per qind, kurse ne vjetin e kaluem te dalunat per ekonomin kane perfshi vetem 23 per qind nderssa te dalunat e pushtetit shtetnuer dhe administratës, te cilat ne buxhetin e vjetit te kaluem kane qene 37 per qind, sivjet jane ne 28,05 per qind, ne krahasim me buxhetin e vjeme, me gjithe se aparati shtetnuer asht zgjanue mjaft.

Ne baze te detyreve qe na parashtrohen ne vjetin e dyte te Planit pesvjeçar, i parashtrohet Keshillit Popullor Krahinuer projekt-buxheti i Krahines Autonome e Kosove-Methohis per vjetin 1948 me t'ardhunat prej 274.565.631 dinaresh dhe te daluna prej 698.206.000 dinaresh, e me nji teprice te dalunash mbi t'ardhunat per nji shume prej 362 640.369 — teprice e cila do te mbulohet me dotacjonet nga buxheti i Republikes Popullore te Serbis.

Shoke keshilltare, nga kjo ndihme e madhe qe na jepet me buxhetin e Republikes s'one Popullore te Serbis, shifet kjartazi dashtunija dhe ndihma e madhe vllaznore qe u ban popujve te Kosmetit populli e Qeverija e RP te Serbis, me krye me shokun Dr. Bilagoje Neshkoviq, popujt e Kosmetit te ngrihen ekonomisht, kulturalisht e ne çdo pikepamje tjeter ne nivelin e popujve te tjere te Republikes Popullore te Serbis.

Detyra ma kryesore e buxhetit t'one te vjetit 1948 asht financimi i ekonomis ne rend te pare i sektorit shtetnuer, i cili perfaqson shtyllen kryesore te zhvillimit te Krahines s'one. Me gjithe ket ne buxhet permbahen dhe mjetet e nevojshme per financimin e te gjitha funksjoneve te jera te lidhuna ne veprimtarin shtetnore.

Shtimi i buxhetit te sivjem ka randesi shum te madhe per Krahinen t'one, sepse i kushton kujdes te posaçem zhvillimit ekonomik, ngritjes kulturale e materjale dhe kujdesimit socjal te turmave te gjana popullore te Krahines s'one. Simbas projekt-buxhetit te ketij vjeti, te dalunat per arsim e kulturen popullore arrijne shumen prej 122,552,349 dinaresh, ase 97,24 per qind ma teper se ne vjetin e kaluem. Per mprojtjen socjale e shendetsore te popullit asht parapa shuma prej 122.020.484 dinaresh, ase 24,53 per qind ma teper se ne vjetin e kaluem. Te dalunat per investimet arrijne shumen prej 202.196.000 dinare, ase 108,33 per qind ma shum se ne vjetin e kaluem. Kur te merret parasyshe se investimet republikane arrijne shumen ma se nji qind miljone dinare, na rezulton e kjarte se çfare perpjekjesh bahen per zhvillimin ekonomik te Krahines s'one.

Ne projekt-buxhetin e ketij vjeti jane parapa edhe shuma te konsiderueshme per ngritjen e kuadrave si dhe per zhvillimin e fakultures.

T'ardhunat e buxhetit qe i paguen populli ne forme tatimi, jane shtue per 24 per qind ne krahasim me vjetin e kaluem. Kjo shtese vjen kryekeput per shkak te shtimit te tatimit ke puntoret e nepunsat nga shtimi i fondit te rrogave, i cili, simbas shenimeve jo te plota nga regjistrimi i muejit mars te ketij vjeti arrine ne ma se nji miljard dinare, kundrejte 630 miljonesh, ne vjetin e kaluem.

Keshillat qe lane mbas dore ekonomin lokale dalin automatikisht jasht luftes per realizimin e Planit pesvjeçar

—tha shoku Gjoko Pajkoviq—

Ne diskusjon mbi buxhetin, Kryetari i Komisjonit te Planit te Keshillit Popullor Krahinuer, shoku Gjoko Pajkoviq, ne mes te tjerash tha:

—„Buxheti i propozuem asht per 54% ma i madh se ai i vjetit te kaluem. Çka don me thane kjo, kur kemi parasyshe se me kete buxhet nuk perfshihen t'ardhunat e industris lokale?

Kjo asht prove e ngritjes se fuqis ekonomike te Vendit t'one dhe suksesevet te mberritjuna ne ndertimin socjalist. Kjo mandej tregon se Qeverija e Republikes Popullore te Serbis e zbaton drejte ligjin mbi Planin pesvjeçar per sa i perket te ndihmuemit te viseve te mbrapambetuna ne ngritjen e tyne ekonomike.

Por karakteristika kryesore e buxhetit asht ma teper ne strukturen e tij. Buxheti i jone nuk asht administrative, por kryesisht fond investimi per ngritjen ekonomike te Krahines s'one. Shtesa ne buxhet tregon forcimin ekonomik te Krahines s'one dhe siguron nji zhvillim ma te shpejte. Shtimi i perqindjeve ne buxhetin e sivjem na tregon se vetem elektrifikimi e industrijalizimi sigurojne nji zhvillim te shpejte ekonomik dhe, prej kendej edhe ngritjen e mireqenjes materjale dhe nivelit kultural te popujve t'one."

Mbassi e permendi plotsimin e detyrve me plan ne çdo sektor pune, shoku Pajkoviq tha se keto rezultate na flasin mbi zhvillimin e gjithanshem ekonomik dhe kultural te Krahines s'one me nji rithem te pashembullt. „Ne vjetin e kaluem kemi fillue me ndertue 74 objekte ekonomike e kulturale — tue mos i llogarite shtepijat e banimit ne qytet e katund — te cilat kryesisht jane krye ose do te kryhen mbrenda ketij vjeti. Kshtu, si dhe me racjonalizimin e sipermarrjeve qe kemi — ne te cilat ka qene teknika shum e mbrapambetun — jane krijue kushtet qe ne kete vjet te shtohet vlefta e prodhimit t'ekonomis lokale per disa here ma teper ne krahasim me vjetin e kaluem. Ne kete vjet do te ngrejme kapacitetin e sipermarrjeve t'ona lokale e krahinore, ne menyre qe prodhimi i tjegullave do te shtohet per 33%, prenja me maqine e tullave me 178%, prodhimi industrijal i gelqeres per 600% dhe prodhimi i gurve per mullij me 100%, ne krahasim me vjetin e kaluem. Do te fillojne nga puna sipermarrje te reja t'industris se mobiljeve e orendive. Keto do te prodhojne 24.000 cope orendi te ndryshme, 800 meter kub shper-pllaka, 100 meter kub pllanet—pllaka, 200 meter kub lande qe do te perpunohen ne mobilje zyrash etj. Ketu duhet me shtue se me nacjonalizmin e ri te sipermarrjeve private, kane kalue ne duer te popullit e nen administrimin e organeve te pushtetit popullor 24 sipermarrje industrijale, 14 hotele dhe disa dhetshe lokalesh tjera private. Kjo tregon se ekonomija lokale po zhvillohet shpejt.

Nuk asht e tepert me theksue randesin e zhvillimit t'ekonomis lokale te Krahines s'one si dhe randesin e ekonomis lokale per zhvillimin ekonomik te shtetit t'one. Para luftes dhe gjate saje njerzit nuk kane mujte me ble kurrfare mobiljesh ne Krahinen t'one, e cila asht e begatshme me druj te çdo lloji. Krahina e jone e ka dhenun ma te mire, i cili asht eksportue e eksportohet edhe tash per fabrikimin e tjegullave dhe prodhimeve tjera keramike. E ora perpara tjegulla ka pase shum pak dhe bleheshin jasht Krahines. Bluemja e drithit te Kosoves bahej jashte Krahines. Me kryemjen e Planit pesvjeçar kjo anomali pa tjeter do te zhduket.

Por prap se prap rrithmi i zhvillimit t'ekonomis lokale nuk asht si duhet me qene. Shkaku kryesuer asht se nuk i asht kushtue kujdes i duhun udheheqjes s'ekonomis lokale as nga ana e Keshillit Popullor Krahinuer as nga ana e keshillave popullore te qyteteve e te rretheve. Keshillat popullore te vendeve, te rretheve dhe te qyteteve nuk e kane planin e zhvillimit t'ekonomis lokale. Mendimi i vjeter burokratik se „duhet me prite qe çashtja te zgjidhet nga nalte" mbretnon ne keshillat t'ona dhe e pengon inisjativen e njerzve, qe mund dhe duhet ta ndihmojshin me punen e tyne zhvillimin e ekonomis lokale.

Krahina e jone asht plot begatina natyrore: pyje, minjera te çdo lloji, toke virgjen te kualitetit te mire, ujna minerale, kullota te mira, pemishte. Por ende keto, ketu para syve t'one mbeten pa u-çfrytzue e pa u-perdore ne lufte per realizimin e Planit pesvjeçar. Pse te themi se nuk kemi dru zjarmi e kerkojme, kur kemi pyje e minjera te qymyrit? Çka te themi per sipermarrjet t'ona qe blejne nga viset tjera kumbulla te thata, pekmez, reçel etj., kurse na kemi mjaft peme? A thue nuk asht e vertete se njerzit udhtojne nga 40 km. per te ndreq shatin sakicen etj., per shkak se ne reonin e keshillit te rrethit te vet nuk ka puntori te tefilla? Te gjith e dini se e blejme shpesh here qerren e thjeshte te katundit jashta Krahines, me gjithse se kemi çdo gja qe na nevojitet per punimin e tyne. Ne disa rrethe katundaret udhtojne nga shum dhetsha kilometrash per te blue drithin, kurse na eksportojme gur per mullij jashte shtetit t'one. Te gjitha keto jane prove e interesimit te dobet dhe inisjatives se paket per zhvillimin e ekonomis lokale."

Tue fole per sipermarrjet lokale, shoku Pajkoviq, nder te tjera tha:

"Keshillat t'ona duhet t'a kuptojne se politika e Qeveris se RFPJ dhe RP te Serbis, e cila shprehet edhe me propozimin e ketij buxheti, ku nuk jane parapa t'ardhunat nga ekonomija lokale-ka per qellim me e nxite zhvillimin e ekonomis lokale. Nga akumulimi qe do t'a realizojne sipermarrjet lokale duhet me u-zhvillue ekonomija lokale pertej kufijve te planit investicjonal. Kjo nuk do te mundet me u-realizue ne qofte se sipermarrjet lokale presin, si deri tash, kontigente landesh te para nga damja me plan, ne qofte se kapaciteti i tyne mbetet pa u-çfrytezue. Shoku Kardelj, ne Sesjonin e prillit te Kuvendit Popullor te RFPJ ka thane: "Ne qofte se keshillat t'ona popullore do te jetojne kryesisht nga t'ardhunat fiskale, nuk do te jene organizatore t'afte t'ekonomis socjaliste-t'ekonomis lokale, nuk do te jene t'afte me i mobilizue te gjitha burimet lokale ekonomike, nuk do te marrjne me e zhvillue inisjativen e vet per sa i perket ngritjes se standardit shoqnuer e kultural te turmave punonjese ne teritorin e vet".

Mbassi theksoi se keshillat popullore qe lane mbas dore ekonomin lokale dalin automatikisht jasht luftes per realizimin e Planit pesvjeçar, shoku Pajkoviq vazhdoi:

"Si çashtje me randesi qe shtrohet ne lidhje me projekt buxhetin asht realizimi i planit investicjonal. Po te merret marasyshe se, simbas buxhetit te propozuem, tue mos i llogarite investimet federale e republikane, plani investicjonal shtohet per 47%, e se te vjetshmin e kemi krye me 92,9%, do te mundet me u-kuptue i gjithe serjoziteti i detyreve ne ket sektor pune. Perveç kesaj me rastin e zbatimit te planit investicjonal duhet te zbriten shpenzimet e investimit per shumen prej 33.412.000 dinaresh, shpenzimet e ndertimit me 15%. Prandaj keshillat popullore duhet t'a marrin mbi veti kujdesin per te gjitha punimet ne teritorin e tyne,-tue mos u-largue nga objektet me karakter federativ ase republikan, por tue i fute keto bash ne planin e pare te detyrave te veta-gja qe ne vjetin e kaluem nuk asht ba. Mos te ngjaje qe puntoret e kualifikuem te hyjne ne pune tjera; teknikët dhe ekspertat e tjere te hyjne n'administraten, te mos organizohet evidenca, siç ka qene me sipermarrjen lokale ne Peje, e cila gjate gjithe vjetit ka kerkue cement e ne fillim te ketij vjeti i jane gjete ne magazine kater vagona cement. Duhet me i çfrytezue ma mire burimet lokale te materjalit te nevojshem per ndertimin investicjonal e me sigurue nji pjesemarrje edhe ma te gjane ne punen vullnetare per te ndihmue realizimin e planit shtetnuer investicjonal.

Ne buxhetin e sivjem zane vend me randesi investimet ne bujqesi, te cilat ne krahasim me vjetin e kaluem do te shtohen me 270%. Me anen e stacjoneve dhe te farmave model, per ndertimin e te cilave po bahen investime te mdhaja, me anen e zbatimit te masave agroteknike duhet te perpiqemi per shtimin e prodhimit bujqesuer. Vjet jane korre disa sukses ne sektorin e bujqesis: mbjellja e gjithe tokes se punueme, shtimi i siperfaqeve me bimet industrijale per 66%, me bimet per ushqimin e bagtis per 124% ne krahasim me vjetin 1939, si dhe mbjellja e sasinave te mdhaja te fares kualitative. Por prap se prap ka pase te meta. E meta kryesore: bujqesija e jone nuk asht studjue, nuk asht çmue se cila toke asht e pershtatshme per kultivimin e kesaj ase asaje kulture. Prandaj nuk jane caktue as kulturat per t'u kultivue. Keshillat t'ona popullore nuk kane organizue me plan masat per ngritjen e bujqesis. Ata nuk merren sa duhet me zhvillimin e formave ma te nalta te punes kooperativiste ne katund, te cilat, siç thote shoku Kardelj-mund te ndikojne serjozisht ne rritimin e zhvillimit dhe reorganizimit te bujqesis. Maqinat dhe veglat e tjera bujqesore rrijne pa u-shite neper dyqanet t'ona, per arsye se disa nuk mund t'i blejne e keshillat popullore nuk perpiqen, qe keto vegla moderne bujqesore t'i blejne kooperativat per perdorimin e perbashket ne katund. Keshillat popullore duhet t'i kushtojne ma teper kujdes zhvillimit te bujqesis-degu ma e randesishmja e ekonomis ke na. Sistemi i tregtis me çmimet e lidhuna sot e nxite edhe ma teper interesimin e bujqeve per shtimin e prodhimit. Ata e kuptojne gjithnji ma kjarte se me pjesemarrjen e tyne ne realizimin e Planit pesvjeçar dhe kryemjen e detyrimeve ndaj shtetit e zbatimin e masave te tij, permiresojne jeten e vet.

Ne lidhje me sistemin e çmimeve te lidhuna para nesh shtrohet si detyre shum serjoze organizimi i tregtis, si e si te sigurohet shkembimi ma i shpejt dhe ma i lire i mallnave. Per t'a mberri kte sypermarrjet shtetnore dhe organizatat kooperativiste duhet te spastrohen nga elementat spekulues. Nevojitet lufte e vazhdueshme kundra tendencave spekulaese te sektorit privat. Pra, puna per aftesimin e aparatit te tregtis shtetnore dhe kooperative, asht nji nga detyret kryesore te pushtetit.

Kuptohet se kryemja e te gjitha ketyne detyreve te parapame ne ket buxhet mvaret edhe nga t'ardhunat qe duhet t'i realizojne organet e pushtetit. Shtimi i buxhetit ven si obligim shtimin e prodhimit, tejkalimin e planeve te prodhimit nga sipermarrjet, zbritjen e shpenzimeve te prodhimit,-per me mujte me e realizue akumulimin. Por nevojitet edhe ma: organet e pushtetit dhe drejtorinat e sipermarrjeve duhet t'i kryejne detyrimet e tyne financjare ma me shum kujdes dhe me diciplinen qe kerkon plani. Do t'i permendi vetem disa raste pagesh-tije e pakujdesije rreth kesaj çashtjeje: keshilli i rrethit ne Podujeve per tre mujorsha ka majere 32% te tatimit, i Vuçiternes 24%, keshilli, i qytetit te Pejes 17%, nga i tane borshi vjetuer, kurse krejt reston e kane mjerre ne tre muejshin e fundit. Minjera "Kosova" e ka pague tatimin mbi qarkullimin e prodhimeve per tre muej ne fund te marsit, kurse duhet te paguhet ne çdo 10 dite. Minjera "Godesh" asht borsh 250.470 dinare nga vjeti i kaluem. Bashkimi kooperativ i rrethit te Gjakoves nuk ka pague kurgja n'emen te tatimit mbi qarkullimin e prodhimeve te vjetit te kaluem. Ne disa vende tatimi asht mjerre mbrenda nji nate, çka tregon se mjerrja e parregullt e tatimit nuk ka rrjedhe nga pamundesija financjare e debitoreve te tatimit, por nga pakujdesija e keshillave popullore, te cilet shpeshe here harrojne se realizimi i detyreve t'ona te planit mvaret nga realizimi me disipline i planit te t'ardhunave. Ka pase raste te shpeshta qe nji qytetar i vobekt te ngarkohet ma teper te sa nji i pasun. Veçanerisht asht pa se keto gabime kane rrjedhe nga qendrimi shovinist i disa keshilltareve dhe se keto gabimesh jane ba ma teper ne lidhje me shqiptaret. Çfaqjet e ketilla ndikojne negativisht dhe e pengojne serjozisht mobilizimin e massave per kryemjen e Planit pesvjeçar, prandaj, asht detyre e te gjithe qytetareve qe te bajne nji lufte ma energjike kundra çfaqjeve te shovenizmit nga çdo ane qe te vijne dhe ne çfardo forme qe te paraqiten".

(Vijon nga faqja e pare)

shkollen dhe ndertesen e re te keshillit popullor. „Si baze te te gjitha suksesevet t'ona ne ndertimin socjalist, tha Prota Smiljaniq, duhet t'a kemi gjithmone lidhmenin e ngushte me shtresat e gjana popullore, nxitjen e inisjatives se tyne, e cila ka ba çudina ne luften çlirimtare me arme dhe ka me ba çudina edhe ne luften per ndertim".

Mandej Prota Smiljaniq foli mbi randesin e kursimit, ne te gjitha format e tija, si dhe luftes kundra atyne qe e çojne poshte pasunin popullore dhe e shpenzojne kohen kot. „Asnji gram, asnji centim kot, asnji minute, asnji sekonde kot. Kjo duhet te jete parulla e jone ne punen t'one te perditshme."

„Ne luften t'one, tha ay, kem veshtiresina, por ato nuk duhet te na ligshtojne. Siç kemi fitue ne kryengritjen, ashtu do te fitojme edhe ne luften per ndertimin e jetes se re, ma te mire. Eksperijenca ka tregue se fiton ay qe ka besim ne fuqin e massave dhe humbe ay qe nuk ka besim ne popullin. Na jemi te sigurte per te tashmen e t'ardhshmen qysh se e kemi pushtetin t'one popullor, Frontin t'one popullor, Armaten t'one popullore, Partin e lavdieshme Komuniste te Jugosllavis dhe shokun Tito, organizatori i fitoreve t'ona te perparshme, te tashme dhe t'ardhshme."

Si ne çdo fushe, edhe ne lamen kulturale, Qeverija Qendrore e RFPJ dhe ajo e RP te Serbis ndihmojne pa kursim Krahinen t'one

—tha shoku Xhavit Nimani

Shoku Xhavit Nimani diskutoi mbi buxhetin ne lidhje me arsimin e kulturen.

"Ne projek-buxhetin e Krahines s'one, tha ai-nji vend me randesi i asht dhane arsimit dhe kultures. Kjo mase nuk asht e rastit, por i pergjigjet karakterit thellesisht popullor te pushtetit t'one".

Mjafton te hedhim nji veshtrim ne punen kulturo-arsimore gjate kohes se Jugosllavis se vjeter dhe gjate vjeteve te çlirimit-shtoi shoku Xhavit. "Ne kohen e Jugosllavis se vjeter ma teper se 90% te popullsis shqiptare dhe nji piese mjaft e madhe serbesh e malazezesh kane qene analfabete. Mbrenda vjetve te çlirimit te Vendit t'one kane mesue te shkruejne e te kendojne ma se 100.000 mashkuj e fem ma shqiptare, serbe e malazeze. Plani i ketij vjeti jo vetem qe do te plotesohet, por edhe do te tejkalohet, mbassi kursistat qe nuk kane marre pjese ne provime do t'a vazhdojne punen edhe nder muejt e ardhshem. Ne ket vjet sukses te mire kemi pase e ,he nder kurset arsimore. „Ne Krahinen t'one kemi dhe do te kemi edhe ma shum shtepija kulture per masat e gjana popullore, kemi nji numer buker te mire sallash leximi e biblioteka nder qytete e katunde, e kemi te gjalle rrjeten kinematografike dhe ate te dranteve, ne pershtatmeni me edukimin e masave te gjana me frymen e re-thot shoku Xhavit. «Perveç ketyneve-shtoi ai— asht per t'a vue ne dukje randesin e madhe qe ka shtypi ne Krahinen t'one

Tash ke na botohen gazeta e revista ne gjuhen shqipe dhe gazete ne serbishte, botohen libra dhe broshura ne gjuhen t'one amtare, te cilat jane shperndа an'e kand Krahines s'one.

Mbassi i vueni ne dukje te gjitha keto, shoku Xhavit tha: "ne kohen e regjimeve antipopullore kultura ka qene monopol per klasen kapitaliste. Njerezve prej masave te gjana popullore u jane dhane aq njohunina dhe edukim, sa me ia sigurue profitet kapitalistave dhe si e si ato te bahеshin skllave te bindun t'atyne. Ke na kultura asht prone e masave te gjana popullore dhe u sherben vetem atyne".

„S'duhet te harrojme se qeverija Qendrore e RFPJ dhe ajo e RP te Serbis-shtoi shoku Xhavit-po e ndihmojne pakursim Krahinen t'one ne çdo ane e ne çdo drejtim, si e si populli i jone t'arrije ne nji nivel te barabarte me gjithe popujt vllazen te Jugosllavis. Kjo ndihme kaq e madhe dallohet edhe ne politiken e drejte arsimore, e cila synon ma teper per t'u ardhe ne ndihme popujve ma te mbrapambetun, si ne shqiptareve etj".

Ma ne fund ai i vueni ne dukje disa prej sukseseve, dhe disa te meta n'arsimin fillor, te mesem e n'ate popullor: "Botimi i disa teksteve per shkollat fillore shqipe ka qene nji sukses i dukshem, mbassi ne Krahinen t'one per heren e pare jane botue keto ne gjuhen amtare te shqiptareve. Ne mungese te kuadrave arsimore te kualifikueme, kemi emnue disa mesues te pa-afte, prandaj ne disa shkolla kemi pase kualitet jo aq te mire ne mesime. Per t'i zhduke keto te meta, pushteti i jone ka ndermarre qe te hape gjate pushimeve te ketij vjeti kursin pedagogjik per shqiptare. Po kesi kualiteti ka pase edhe nder gjimnaze, e sidomos nder ato shqiptaret. Nuk asht kuptue prej te gjithe arsimtareve qe kultura ke ne asht e perbashket per te gjithe popujt e Jugosllavis; disa profesore nuk i kane dhane kurrfare randesije edukimit te rinis shkollore me frymen marksiste-leniniste, por perkundrazi ne shum raste ata kane perdore tekste me fryme e edukate te damshme. Ka pase raste qe disa arsimtare mos te pajtohen me zhvillimin e Jugosllavis se re ne bazat e socjalizmit.

Tue e perfundue diskutimin e tij shoku Xhavit, parashtroi si detyre kryesore jo vetem per Drejtoratin Arsimuer, por edhe per te gjitha keshillat popullore, qe te kontrollohet vazhdimisht jeta e perditshme shkollore, te permiresohet kualiteti i punes nder shkolla; qe keshillat popullore mos te presin plane vetem prej organeve ma te nalta, derisa asht shum ma e drejte qe ato te dalin prej se poshtmi-nalte".

31. Maj 1948

RILINDJA flet' e posaçme

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

Vdekje Fashizmit — Liri Popullit!

Rilindja" Botore e perjaveshme. Redaksija: Rruga Emin Duraku Nr. , Prishtine. Pajtimet i pranon administrata dhe ekspeditioni „Rilindja". Numri i cekut 38 — 90 60 30.

Kryeredaktor pergjegjes: Xhetadin Hana

Taksa postale e pagueme

STATUTI

I KRAHINES AUTONOME TE KOSOVE — METOHIS NE REPUBLIKEN POPULLORE TE SERBIS

Kapitulli i Pare

Dispozita te pergjithshme

Art. 1.

Krahina Autonome e Kosove-Metohis asht Krahine Autonome ne kuadrin e Republikes Popullore te Serbis.

Art. 2.

Me qellim realizimi te parimeve te bashkpunimit vllaznuer ne mes te kombesive, qe jetojne ne Krahinen e Kosove-Metohis, dhe te drejtave te pakicave nacionale te konfirmueme ne Statutin e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Statutin e Republikes Popullore te Serbis, si dhe tue marre parasyshe veçorin e saje nacionale, Krahina Autonome e Kosove-Metohis, ne pajtim me vullndetin e lire te shprehun prej popullit, gezon te drejtin te veçanta autonome te konfirmueme me ket Statut.

Te drejtat e autonomis se Krahines Autonome te Kosove-Metohis jane te garantueme me Statutin e Republikes Popullore te Serbis ne pajtim me Statutin e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis.

Art. 3.

Te gjitha kombesit ne Krahinen Autonome te Kosove-Metohis , jane me te drejta te barabarta.

Gjuha serbe dhe shqipe perdorohen me te drejta te barabarta ne te gjitha zyrat shtetnore te Krahines Autonome te Kosove-Metohis.

Gjykimi para gjyqeve bahet ne gjuhen serbishte ase shqipe.

Art. 4.

Krahina Autonome e Kosove-Metohis perfshin teritorin:

1) e rretheve te tashme: Vuçiterne, Gilan, Gore, Graçanice, Drenice, Gjakove, Zveçan, Istok, Kamenice, Llab, Nerodimlje, Peje, Podrime, Sitnice Suhareke dhe Mali i Sharit;

2) qyteteve te tashme: Mitrovice, Prizren, Peje e Prishtine.

Art. 5.

Qendra e organeve ma te nalta te pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore te Krahines Autonome te Kosove-Metohis asht Prishtina.

Kapitulli i Dyte

Te drejtat te autonomis e Krahines Autonome te Kosove—Metohis

Art. 6.

Populli I Krahines Autonome te Kosove-Metohis e ushtron pushtetin me ane t'organeve perfaqesuese, te zgjedhun lirisht, te pushtetit shtetnuer, Keshillit Popullaer Krahinuer te Krahines Autonome te Kosove—Metohis dhe keshillave popullore, te zgjidhen ne baze te se drejtes se pergjithshme, te barabarte dhe direkte te votimit me vota te mshefta.

Art. 7.

Te gjitha organet e pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore te Krahines Autonome te Kosove-Metohis i ushtrojne ne teritorin e vet funksjonet e pergjithshme te pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore ne baze te Statutit te RFPJ dhe Statutit te RPS, ligjeve te RFPJ dhe ligjeve te RPS, dispozitave te pergjithshme dhe udhezimeve te Qeveris se RFPJ e antarve te saj dhe Qeveris se RPS te antarve te saje, si dhe funkcjonet ne sferen e autonomis ne baze te ketij Statuti.

Art. 8

Krahina Autonome e Kosove—Metohis, ne personen e Keshillit Popullaer Krahinuer dhe te Keshillit te tij Ekzekutiv kryen keto pune:

1) bjen, ndryshon dhe plotson Statutin e KAKM me aprovimin e Kuvendit Popullaer te RPS;

2) aprovon statutet e keshillave popullore te rretheve dhe qyteteve;

3) vendose mbi ndamjen e vendeve te ndryshme te banueme ose te pjesve te tyne nga perbamja e teritorit te keshillit popullaer te vendit, si dhe mbi korigjimin e kufijve te teritoreve te keshillave popullore te vendeve, me aprovimin e Presidiumit te Kuvendit Popullaer te RPS;

4) I ruen te drejtat e qytetarve dhe siguron aplikimin e ligjeve;

5) Kujdeset per barabarsin e kombesinave te Krahines;

6) udheheqe ndertimin ekonomik te Krahines;

7) aprovon dhe realizon planin ekonomik te Krahines ne kuadrin e planit ekonomik te Republikes Popullore te Serbis, kontrollon zbatimin e planit;

8) aprovon buxhetin e Krahines ne kuadrin e buxhetit te Republikes Popullore te Serbis; realizon dhe kontrollon kryemjen e buxhetit te KAKM dhe aprovon llogarin perfundimtare;

9) drejton sipermarrjet dhe institutet ekonomike shtetnore me karkter krahinuer dhe realizon udheheqesin me sipermarrjet dhe institutet ekonomike me karakter lokal;

10) I administron rruget, lumejt dhe kanalet me karakter krahinuer ne kuadrin e dispozitave te Republikes Popullore te Serbis;

11) e drejton transportin dhe komunikacjonin me karakter Krahinuer ne kuadrin e dispozitave te Republikes Popullore te Serbis;

12) realizon kontrollin mbi gjendjen e sipermarrjeve dhe institutеve me karakter te pergjithshem shtetnuer e republikan te teritorit te KAKM;

13) realizon udheheqsin mbi shkollat fillore e te mesme ne kuadrin e planit te pergjithshem arsimuer te Republikes Popullore te Serbis;

14) Drejton institutet kulturo-arsimore me karakter Krahinuer;

15) realizon udheheqsin mbi punet komunale ne teritorin e KAKM;

16) realizon udheheqsin mbi punet e sigurimit social;

17) realizon udheheqsin mbi sherbimin e mprojtjes se shendetit popullaer;

18) realizon dhe i udheheqe punet qe i jane lane ne kompetence KAKM me ligje dhe dispozita te pergjithshme te Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Republikes Popullore te Serbis;

Art. 9

Ne teritorin e Krahines Autonome te Kosove-Metohis, keshillat popullore te vendeve, qyteteve e rretheve, si organet ma te nalta te pushtetit shtetnuer ne marredhanjet me karakter lokal, realizojne ne teritorin e tyne edhe detyrat nga qarku autonom i veprimit te Krahines ne baze te dispozitave dhe udhezimeve te pergjithshme te Keshillit Popullaer Krahinuer te KAKM dhe Keshillit te tij Ekzekutiv.

Art. 10

Keshilli Popullaer Krahinuer i Krahines Autonome te Kosove-Metohis realizon udheheqsin e pergjithshme mbi te tane veprimtarin e keshillave popullore ne teritorin e Krahines.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer realizon udheheqjen e pergjithshme mbi mbare veprimtarin e keshillave ekzekutive te keshillave popullore ne teritorin e Krahines.

Kapitulli i Trete

Marredhanjet reciproke ndermjet organeve te pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore te Republikes Popullore te Serbis dhe Krahines Autonome te Kosove—Metohis

A) marredhanjet e organeve ma te nalta te pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore te Republikes Popullore te Serbis dhe Krahines Autonome te Kosoves e Metohis

Art. 11

Marredhanjet ne mes t'organeve ma te nalta te pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore te Republikes Popullore te Serbis dhe Krahines Autonome te Kosove-Metohis, bazohen ne te drejtat dhe detyrat e caktueme me Statutin e Republikes Popullore te Serbis ne pajtim me Statutin e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis me ligjet e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Republikes Popullore te Serbis dhe me Statutin e Krahines Autonome te Kosove-Metohis.

Art. 12

Presidiumi i Kuvendit Popullaer te RPS ka te drejte me i anulue e me i syprimue vendimet Krahinore ne qofte se nuk jane ne konformitet me Statutin dhe ligjet e RFPJ dhe me kete Statut. Nen te njajtat kushte Qeverija e RPS mundet me e ndalue aplikimin e vendimeve Krahinore dhe me ia paraqite Presidiumit te Kuvendit Popullaer te RPS per me prue vendimin per to.

Keshilli Popullaer Krahinuer i Krahines Autonome te Kosove-Metohis ka te drejte, persa u-perket vendimeve Krahinore, te marruna ne kuadrin e kompetences Autonome, me ia dergue proponimin Kuvendit Popullaer te RPS per me e shqyrtue konformitetin e dispozitave t'anulueme ase te syprimueme me Statutin e Krahines Autonome te Kosoves e Metohis, e ne baze te kesaj me marre vendim definitiv mbi ligjeshmenin e vendimeve Krahinore.

Art. 13

Qeverija e Republikes Popullore e Serbis ka te drejte me i anulue e syprimue urdhnat, udhezimet dhe vendimet e paligjeshme te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer qe jane prue ne rrethin e veprimtaris se puneve Krahinore; ne punet e kompetences federative ase republikane, Qeverija e Republikes Popullore te Serbis e ka kete te drejte edhe persa iu perket akteve te padrejta te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer.

Antaret e Qeveris se RPS kane te drejte me i anulue ose me i syprimue aktet e paligjeshme te te Besuemve perkates te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer, te cilat jane marre ne rrethin e veprimtaris se punve krahinore; ne punet e kompetences federative ose republikane, antaret e Qeveris se RPS kane te drejte edhe persa iu perket akteve te padrejta te te Besuemve te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer ka te drejte persa u-perket dispozitave te pergjithshme te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer dhe te Besuemve te tij te prueme ne punet e kompetences Krahinore, me ia dergue proponimin Presidiumit te Kuvendit popullaer te RPS ose Qeveris te RPS per me prue vendimin definitiv mbi ligjeshmenin e aktit t'anuluem ose te syprimuem te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer ose te besuemeve te tij.

Art. 14.

Marredhanjet ne mes t'organeve ma te nalta te pushtetit shtetnuer te Republikes Popullore te Serbis dhe t'organeve e pushtetit shtetnuer te njisive administrativo-teritoriale ne teritorin e Krahines Autonome te Kosoves e Metohis jane konfirmue me ligje dhe me dispozita te tjera te pergjithshme te Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe te Republikes Popullore te Serbis ne konformimet me Statutin e RFPJ dhe statutin e RPS e edhe me ket Statut.

B) Marredhanjet ne mes t'organeve ma te nalta te pushtetit shtetnuer dhe te drejtimit shtetnuer te Krahines Autonome te Kosove—Metohis e te keshillave popullore

Art. 15

Keshilli Popullaer Krahinuer i Krahines Autonome te Kosove e Metohis ka te drejte me i anulue ose suprimue vendimet, urdhnat e udhezimet e paligjeshme e te padrejta te keshillave popullore ne teritorin e Krahines, e ne konformitet me parimet e konstatueme me ligje. Keshilli Ekzekutiv i Keshillit Popullaer Krahinuer te KAKM ka te drejte me i ndalue aktet e kilia te keshillave popullore dhe me ia paraqite per vendim definitiv Keshillit popullaer Krahinuer te KAKM.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer ose te Besuemit e tij kane te drejte, mbrenda kompetences se vet, me i anulue ose suprimue urdhnat, udhzimet dhe vendimet e paligjeshme e te padrejta te keshillave ekzekutive te keshillave popullore, ose te drejtoraleve te tyne ne teritorin e Krahines e ne pajtim me parimet e konfirmueme me ligje. Nen te njajtat kushte i Besuemi i Keshillit Ekzekutiv Krahinuer ka te drejte, mbrenda kompetences se vet me i anulue aktet e Keshillit Ekzekutiv te Keshillit Popullaer ne teritorin e Krahines dhe me ia paraqite Keshillit Ekzekutiv per vendim definitiv.

Art. 16

Keshilli Popullaer Krahinuer i Krahines Autonome te Kosove e Metohis ka te drejte me e shpernda (pushue) ndonji keshille popullaer ne teritorin e Krahines, ne qofte se puna e ketij kshilli asht ne kundershim te dukshem me Statutin e Krahines Autonome te Kosove e Metohis, me Statutin e RFPJ dhe me Statutin e RPS me ligjet e RFPJ e ligjet e RPS dhe me i shpalle zgjedhjet per keshillin e ri popullaer.

Keshilli Popullaer Krahinuer i Krahines Autonome te Kosove e Metohis ka te drejte me e shgarkue nga puna Keshillin Ekzekutiv te Keshillit popullaer ne teritorin e Krahines ne qofte se puna e tij asht ne kundershtim te dukshem me Statutin e K A K M, me Statutin e RFPJ dhe me Statutin e RPS, me ligjet e RFPJ e ligjet e RPS dhe me e mbledhe Keshillin Popullaer ne kuvend te jashtezakonshem per zgjedhjen e keshillit te ri ekzekutiv.

Kapitulli i Katerte

Organet ma te nalta te pushtetit shtetnuer dhe drejtimit shtetnuer te KAKM

A) Keshilli Popullaer Krahinuer i Krahines Autonome te Kosove—Metohis

Art. 17

Organi ma i nalte i pushtetit shtetnuer ne Krahinen Autonome te Kosove e Metohis asht Keshilli Popullaer Krahinuer i Krahines Autonome te Kosoves e Metohis.

Keshillin Popullaer Krahinuer te KAKM e zgjedhe populli i Krahines Autonome te Kosove e Metohis me vota te mshefta ne baze te drejtes se pergjithshme, te barabarte e direkte te votimit.

Art. 18

Keshilli Popullaer Krahinuer i KAKM zgjidhet per tri vjet.

Ne çdo 2500 banore zgjidhet nga nji keshilltar i Keshillit Popullaer Krahinuer te KAKM.

Art. 19.

Mbledhjet e Keshillit Popullaer Krahinuer te KAKM jane te rregullta dhe te jashtzakonshme. Mbledhjet i thirret Keshilli Ekzekutiv Krahinuer.

Mbledhjet e rregullta bahen ne çdo tre muej. Mbledhjet e jashtzakonshme bahen kur Keshilli Ekzekutiv Krahinuer e shef nevojen ose kur t'a kerkoje gjysma e keshilltarve, Presidiumi i Kuvendit Popullaer te RPS ose Qeverija e RPS.

Art. 20

Per Kryesin e seancave, Keshilli Popullaer Krahinuer i KAKM e zgjedhe kryetarin, nenkryetarin e sekretarin.

Kryetari, nenkryetari e sekretari e kryejne detyren deri ne zgjedhjen e Kryesis se mbledhjes s'ardheshme, e perputhin punen e keshillave dhe komisioneve dhe e pregadisin mbledhjen e ardheshme te Keshillit Popullaer Krahinuer.

Art. 21

Keshilli Popullaer Krahinuer i KAKM e ban rregulloren e punes se tij.

Seancat e Keshillit Popullaer Krahinuer te KAKM, simbas rregullit, jane te hapta.

Art. 22

Keshilli Popullaer Krahinuer i KAKM asht ekskluzivisht kompetent:

1. me aprovue, ndryshue dhe plotesue Statutin e Krahines Autonome te Kosove-Metohis me aprovimin e Kuvendit Popullaer te RPS.

(vazhdon ne faqen tjeter)

STATUTI

I KRAHINES AUTONOME TE KOSOVE — METOHIS NE REPUBLIKEN POPULLORE TE SERBIS

(Vijon nga faqja e pare)

2. me zgjedhe dhe pushue kryetarin e nenkryetarin, sekretarin dhe antaret e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer te Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM;

3. me ndryshue kufijt e rretheve, qyteteve dhe teritoreve te keshillave popullore te vendeve me aprovimin e Presidiumit te Kuvendit Popullner te RPS;

4. me aprovue buxhetin dhe planin ekonomik te KAKM, me e aprovue llogarin perfundimtare;

5. me vendose mbi lidhjen e ubanave;

6. me i caktue tatimet e ndryshme ne Krahine mbrenda kufijve te ligjit;

7. me formue sipermarrje dhe institute me karakter lokal;

8. me aprovue dispozita te pergjithshme, vendime-krahinore;

9. me aprovue Statutet e keshillave popullore te qyteteve dhe te rretheve;

10. me i shpernda keshillat ma t'ulta popullore, me pushue keshillat ekzekutive te keshillave ma t'ulta popullore.

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM vendose edhe mbi te gjitha çashtjet tjera qe ia kane lane ne kompetence ligjet e RFPJ dhe RPS.

Art. 23

Mbas verifikimit te mandateve, antaret e Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM bajne kete betim:

„Betohem me nderin t'im dhe me nderin e popullit t'im se gjithmone do t'i perfaqesoje, mproje te drejtat demokratike dhe lirin e popujve te Krahines Autonome te Kosove-Mtohis ne kuadrin e Republikes Popullore te Serbis dhe popujve te Republikes Popullore te Serbis, se do t'i kushtoje te gjitha uftesit dhe dijen t'ime ne punen per ndertimin e shtetit popullner dhe per ngritjen e mireqenjes se popullit punonjes; se do t'a roej besnikisht vllaznimin, bashkimin dhe lirin e popujve te shtetit t'one te perbashket, Republikes Federative Popullore te Jugosllavis; se palodhemenisht do t'i mproje frytet e luftes çlirimtare te popujve dhe se detyren t'ime si keshilltar do t'a kryej me ndergjegje dhe palodhmenisht.

Art. 24

Te drejte me i ba propozime Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM kane Keshilli Ekzekutiv Krahinuer dhe keshilltaret popullore te Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM.

Mbi propozimet e bame Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM vendose me shumicen e votave ne seancen ku te jene prezent shumica e keshilltareve te Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM.

Art. 25

Çdo keshilltar popullner i Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM ka te drejte te flase ne gjuhen e kombesis se vet.

Art. 26

Ne seancat e Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM marrin pjese ne pune e kane te drejte vote vetem keshilltaret e Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM. Ne seancat e Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM mund t'a marrin fjalen edhe perfaqesuesit e organeve eprore te pushtetit shtetnuer dhe t'administrates shtetnore, por vetem me pelqimin e Keshillit popullner Krahinuer te KAKM.

Art. 27

Keshilli Popullner Krahinuer KAKM aprovon me vendim buxhetin, llogarin perfundimtare dhe planin ekonomik te Krahines Autonome te Kosove-Metohis

Art. 28

Vendimi Krahinuer hyn ne fuqi diten e shpalljes ne „Fletoren Zyrtare te Krahines Autonome te Kosove-Metohis", ne se ne vet-vendimin nuk asht vendose ndryshej.

Vendimet i nenshkruejne kryetari dhe sekretari i Keshillit Ekzekutiv Krahinuer te KAKM.

Art. 29

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM mund te zgjedhe keshilla dhe komisione, te cilave u beson pune te caktueme.

Ne mbledhjen e pare Keshilli popullner Krahinuer i KAKM zgjedhe keshillin verifikues, i cili i kontrollon mandatet e keshilltareve.

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM me propozimin e keshillit verifikues i aprovon ose i anulon mandatet e keshilltareve popullore.

Art. 30

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM mund te kryeje anketa mbi çashtjet nga kompetenca e vet autonome me ane te komisjoneve te posaçme te tija t'anketes.

Te gjitha organet shtetnore te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis kane per detyre me i zbatue kerkesat e komisjoneve t'anketes ne pikpamje te konstatimit te fakteve dhe te mbledhjes se materjalit deshmues.

Art. 31

Keshilltaret popullore te Keshillit Popullner te KAKM kane te drejte dhe detyre me asistue ne mbledhjet e Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM dhe tue marre pjese aktive ne punen e tij dhe ne punen e keshillave dhe komisjoneve, tue i krye me ndergjegje te gjitha detyrat qe u jane besue.

Art. 32.

Keshilltaret popullore te Keshillit Popppullner Krahinuer te KAKM gezoj ne imunitet ne teritorin e Krahines Autonome te Kosove e Metohis.

Keshilltaret popullore te Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM nuk mund te burgosen dhe kunder tyne nuk mund te bahet proçesi gjyqsuer pa lejen e Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM ose pa lejen e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer, kur Keshilli Popullner Krahinuer nuk asht mbledhe, perveç ne rastin e kapjes ne flagrant, mbi te cilen gja me nji here duhet me e lajmerue pa tjeter Keshillin Ekzekutiv Krahinuer.

Art. 33

Votimet per Keshillin e ri Krahinuer te KAKM pa tjeter duhet te jene te shpalluna para mbarimit te dites se fundit t'afatit per te cilin asht zgjedhe Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM.

Nga dita e shperndarjes se Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM deri ne diten e zgjedhjes te Keshillit te ri Popullner nuk mund te kalojne ma se dy muej.

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM, i zgjedhun rishtaz mblidhej ma se largu nji muej mbas votimeve te kryeme.

Art. 34

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM ban ndryshime dhe plotsime te Statutit te KAKM.

Propozimin per ndryshimet dhe plotsimet e Statutit mund ta baje Keshilli Ekzekutiv Krahinuer ose se paku nji e katerta pjese e keshilltareve te Keshillit Popullner te KAKM.

Propozimi qe te filloje zgjedhja mbi ndryshimet dhe plotsimet e Statutit duhet te jete i pranuem ne Keshillin Popullner te KAKM me shumicen e votave.

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM e ka aprovue propozimin mbi ndryshimet dhe plotsimet e Statutit ne qofte se per propozimin ka votue shumica e numrit te tane te keshilltarve popullore te Keshillit Popullner te KAKM.

Ndryshimet dhe plotsimet e kryeme ne Statut i parashtrohen Kuvendit Popullner te Republikes Popullore te Serbis per aprovim.

Ndryshimet dhe plotsimet e aprovueme te Statutit, shpallen ne „Fletoren Zyrtare te Krahines Autonome te Kosove e Metohis" e i nenshkruen kryetari dhe sekretari i Keshillit Ekzekutiv Krahinuer.

B) Keshilli Ekzekutiv Krahinuer i Keshillit Popullner Krahinuer te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis

Art. 35

Organi Ekzekutiv dhe drejtues i Keshillit Popullner Krahinuer te Krahines Autonome te Kosove e Metohis, asht Keshilli Ekzekutiv Krahinuer.

Keshillin Ekzekutiv Krahinuer e zgjedhe dhe e shkarkon nga detyra Kuvendi i Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer asht pergjegjes para Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM dhe atij i jep llogari mbi punen e vet.

Ne rase shperndamjeje te Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM, Keshilli Ekzekutiv Krahinuer vazhdon ta kryej detyren per deri sa te zgjidhet Keshilli Ekzekutiv Krahinuer i ri.

Art. 36

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer e drejton dhe e harmonizon punen e drejtorateve dhe Institutеve ne kuadrin e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer e ka ne dore drejtimin e pergjithshem te te gjitha degeve t'administrates shtetnore ne teritorin e Krahines; pregadit dhe propozon planin ekonomik dhe buxhetin Krahinuer dhe kujdeset per zbatimin e tyne; jep plane ekonomike vjetore; pregadite propozimin e vendimeve Krahinore; themelon ndermarrje ekonomike me karakter Krahinuer dhe propozon themelimin e enteve me karakter Krahinuer; i zbaton direkt ose kujdeset per zbatimin e ligjeve dhe urdhnesave t'organeve ma te nalta t'administrates shtetnore te RFPJ dhe RPS; nxjerre rregullore mbi organizimin e mbrendeshem te drejtorateve; themelon komisjone, drejtorina e institute te cilat jane pergjegjese para Keshillit Ekzekutiv Krahinuer per t'i krye detyret dhe punet ne kuadrin e kompetences krahinore te KAKM

Art. 37

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer i Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM jep urdhena, udhezime dhe vendime ne baze dhe me qellim zbatimi te ligjeve te RFPJ, ligjeve te RPS dhe vendimeve te Keshillit Popullner Krahinuer te Krahines Autonome te Kosove e Metohis, dekreteve, urdhnave, udhezimeve e vendimeve te Qeveris se RFPJ, Qeveris se RPS, antareve te Qeveris RFPJ dhe Qeveris se RPS dhe kujdesohet per zbatimin e tyne ne teritorin e Krahines Autonome te Kosoves e Metohis.

Urdhnat, udhezimet dhe vendimet qe i jep Keshilli Ekzekutiv Krahinuer i nenshkruejne kryetari e sekretari i Keshillit Popullner Krahinuer.

Art. 38

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer perbahet prej kryetarit, dy nenkryetareve, Sekretarit e dhet antareve.

Antaret e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer para se me fillue ne detyre e bajne betimin para Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer i zgjedhe nga gjiu i vet kryetarin e komisjonit te planit dhe te Besuemit e degeve te ndryshme t'administrates shtetnore.

Art. 39

Kryetari i Keshillit Ekzekutiv Krahinuer e perfaqson Keshillin Ekzekutiv Krahinuer, i udheheq seancat e tij dhe koordinon punen e drejtorateve te tij.

Nenkryetaret i ndihmojne Kryetarit ne rase se asht i zanun, e zavendesojne ne detyre, drejtojne punen e komisjoneve te veçanta te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer dhe kryejne detyre te tjera qe ua cakton Keshilli Ekzekutiv Krahinuer.

Sekretari i Keshillit Ekzekutiv Krahinuer i pregadite seancat e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer, kujdeset per zbatimin e vendimeve te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer, i ndihmon kryetarit ne koordinimin e punes se drejtorateve dhe udheheqe direkt sekretarjatin e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer.

Art. 40

Per udheheqjen direkte te degeve te ndryshme t'administrates shtetnore ne Krahinen Autonome te Kosove e Metohis, Keshilli Ekzekutiv Krahinuer i ka keto njisina organizative:

1) Drejtoratin e Financeve;
2) Drejtoratin e Punve te mbrendeshme;
3) Drejtoratin e Arsimit;
4) Drejtoratin e Tregtis dhe turizmit;
5) Drejtoratin e Industris;
6) Drejtoratin e Bujqesis;
7) Drejtoratin e Punve botore;
8) Drejtoratin e shendetsis se popullit dhe asistences sociale;
9) Drejtoratin e Punve komunale;
10) Drejtoratin e Punes;
11) Drejtoratin e Rrugeve dhe komunikacjonit lokal;
12) Komisjonin e Planit;

Themelimi i Drejtorateve te reja bahet me ligje e statut.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer mund t'i ndryshoje, bashkoje ose suprimoje drejtoratet qe ekzistojne, me aprovimin e Qeveris se RPS.

Art. 41

Ne krye te Drejtorateve jane te Besuemit, te cilet e drejtojne punen e Drejtorateve dhe jane direkt pergjegjes para Keshillit Ekzekutiv Krahinuer per udheheqje te drejte te punve qe u jane besue.

Ne kufij te kompetences se tyne te Besuemit japin urdhna, udhezime, dhe vendime ne baze dhe me qellim zbatimi te ligjeve te RFPJ dhe ligjeve te RPS, Statutit dhe Vendimeve te KAKM, dekreteve, urdhnesave, udhezimeve dhe vendimeve te Qeveris se RFPJ e Qeveris se RPS, rregulloreve urdhnesave, udhezimeve dhe vendimeve t'antarve te Qeveris se RFPJ e RP te Serbis, urdhnesave, udhezimeve e vendimeve te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer dhe rregulloreve, urdhnesave, udhezimeve e vendimeve t'antarve te Qeveris se RFPJ e Qeveris se RP te Serbis.

Kapitulli i Peste

Dispozitat perfundimtare

Art. 42

Me hymjen ne fuqi te ketij Statuti, bijne nga fuqija te gjitha urdhnesat e dhanuna nga ana e organeve te pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis, qe jane ne kundershtim me kete Statut.

Keshilli Popullner Krahinuer i KAKM mbrenda afatit prej gjasht muejsh nga dita e hymjes ne fuqi te ketij Statuti, do t'i shqyrtoje te gjitha dispozitat e pergjitheshme te dhanuna deri diten e hymjes ne fuqi te Statutit nga organet ma te nalta te pushtetit shtetnuer dhe administrates shtetnore te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis dhe t'i perputhe me Statutin, me Kushtetuten, me ligjet dhe dispozitat e tjera te pergjitheshme te Republikes Popullore te Serbis dhe Republikes Federative Popullore te Jugosllavis. Dispozitat e pergjithshme qe nuk perputhen dhe aprovohen mbrenda afatit te siperthenum, e humbin fuqin juridike.

Art. 43

Ne pajtim me Statutin e RPS, art. 13, paragrafi 3 dhe art. 107, paragrafi 2, pika 1, ky Statut i parashtet per aprovim Kuvendit Popullore te Republikes Popullore te Serbis.

Statuti shpallet me nenshkrimin e kryetarit dhe sekretarit te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer te Keshillit Popullner Krahinuer te KAKM dhe me Vendim te Kuvendit Popullner te Republikes Popullore te Serbis, mbi aprovimin e tij.

Art. 44

Ky Statut hyne ne fuqi mbas aprovimit te Kuvendit Popullner te Republikes Popullore te Serbis diten e shpalljes ne „Fletoren Zyrtare te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis".

Mbi randesin e aprovimit te Statutit te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis ne Republiken Popullore te Serbis

Ne Sesjonin e Dyte te rregullt, te mbajtun me 23 maj te ketij vjeti, Keshilli Popullner Krahinuer aprovoi nji dokument me randesi historike per kombesinat e Kosoves e Metohis. U-votue njizanit Statuti i Krahines Autonome të Kosoves e Metohis ne Republiken Popullore te Serbis. Ky Statut-i pari ne historin e Krahines s'one - asht aprovue ne baze te te drejtave autonome te Krahines se Kosoves e Metohis, te sigurueme me Statutin e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe me Statutin e Republikes Popullore te Serbis. Aprovimi i Statutit asht edhe nji konfirmim i te drejtave dhe lirive demokratike te shqiptarve, serbve dhe malazezve ne Kosmet, fitue ne saje te luftes nacional-çlirimtare te te gjithe popujve t'one.

Statuti rezulton si nevoje e diktueme nga veçorija nacionale e Krahines s'one, ku jetojne bashke shqiptaret, serbet dhe malazezet.Shqiptaret, serbet e malasezet e Kosoves e Metohis, te bashkuem politikisht e ekonomikisht ne Republiken Popullore te Serbis, me te gjithe popujt e Jugosllavis, kane fitue ne Statut nji mjet te fuqishem per zhvillimin e tyne ma te shpejte ekonomik dhe kultural. Ne Jugosllavin kapitaliste, Kosova e Metohija kane qene te coptueme ne tri pjese - pjese e banovines se Zetes, ate te Moraves dhe Vardarit. N'asnjenen prej ketyne banovinave nuk asht kujdesue askush per popullin e ketyne vendeve, nuk asht marre parasyshe fakti se ne Kosove e Metohi jetojne shqiptaret, serbet e malazezet. Kapitalistat e bejleret e kane çfrytezue pa meshire dhe e kane shkele ne menyren ma çnjerzore popullin punonjes te ketij vendi. Dhe as qe mund t'ishte ndryshej: politika e ketille u asht pergjegje ma se miri interesave te tyne te ngushta te klases.

Statuti i Krahines s'one asht Statut i popullit dhe per popullin punonjes: popullsin puntore shqiptare, serbe e malazeze te Kosmetit, te shlirueme nga shtypja kombetare dhe shfrytezimi shoqnuer. Ai asht zbatimi i linjes se drejte te Partis se lavdishme komuniste te Jugosllavis, ne çashtjen nacjonale, linje e cila bazohet ne parimin e te drejtave te barabarta dhe bashkëpunimit vllaznuer ne mes te te gjithë popujve ase kombsinave. Asht realizimi i linjes per te cilen Partija Komuniste e Jugosllavis-meshokun Tito ne krye, asht per-pjeke qysh perpara luftes. Ne saje te kesaj linjeje asht sigurue lirija e pamvaresija e popujvet t'one. Ne saje te kesaj linjeje asht ndertue RFPJ-komuniteti vllaznuer i popujve me te drejta te barabarta. Ne saje te kesaj linjeje pa forcohet edhe ma teper vllaznimi e bashkimi i popujve t'one n'etapen e re te luftes shlirimtare-luftes per realizimin e Planit pesvjeçar, Planit te Titos, luftes per ndertimin e atdheut t'one te perbashket socialist-voter e fatbardhesis se popujve t'one dhe faktor i dores se pare, fille mbas BRSS, ne luften e botes perparimtare liridashese per paqe dhe demokraci te vertete.

Statuti, autonomija e Krahines s'one do t'i perforcoje edhe ma teper lidhjet vllaznore ne mes te tri kombesive te Kosmetit, nga nji ane, dhe nga ana tjeter, ne mes te ketyne dhe popullit vlla te Serbis dhe te gjithe popujve te tjere t'atdheut t'one RFPJ, ne luften e perbashket per ndertimin e socjalizmit.

Autonomija shtron para nesh, njikohesisht, te drejta dhe detyre: te drejten e zhvillimit te lire ekonomik dhe kultural, ne baze te specificitetit nacional te Kosmetit dhe detyren me kontribue edhe ma teper, me punue edhe ma me hov per perparimin e Krahines' s'one, per lulezimin e Republikes s'one popullore te Serbis dhe atdheut t'one te perbashket - Republikes Federative Popullore te Jugosllavis-si tanesi.

N'atdheun t'one socjalist, ne shqiptarve te Kosmetit, per te paren here ne historin t'one, na jane sigurue jo vetem te drejtat por edhe mundesit materjale per zhvillimin t'one kultural ne gjuhen shqipe, per nji perparim te gjithanshem.

Aprovimi i Statutit te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis, ku konfirmohen edhe nji here dhe formulohen juridikisht te drejtat t'ona te fitueme ne saje te luftes se perbashket te te gjithe popujve t'one e qe jane konfirmue edhe ma pare me Konstituten e RFPJ dhe RPS,- le te na jete ne shqiptarve nxitje e duhun e cila, krah per krah me popujt e tjere vllazen serb e malazez, me popullin vlla te RP. te Serbis dhe me te gjithe popujt e tjere te RFPJ, te na shtyje me punue me hov te shumfishuem per çashtjen e ndertimit t'one socjalist, ashtu siç na meson Fronti popullор nen udheheqjen e Partis komuniste dhe shokut Tito.

Të luftojmë per sasi ma te madhe dhe cilsi ma te mire ne bujqsi

Tue diskutue mbi projekt buxhetin shoku Boshko Çakiq ne mes te tjerash tha, se vend me randesi zane te dalunat ne sektorin e bujqesis. Kjo na tregon randesin dhe kujdesin e madh qe ia kushtoo bujqesis Keshilli popullur Krahinuer, si dega kryesore ekonomike te Krahines s'one. Sektori shtetnuer ne bujqesi, si shtylla ma e forte per ngritjen e saj ne nivelin e duhun dhe ku p ravat ka vend te te punes do te luejne rol t madh ne vjetin e dyte te Planit pjesvecar. Kooperativat jane ferma ma e mire per ngritjen e bujqesis, per shtimin e prodhimit bujqesuer, per perdorimin e planifikimit e te metodave shkencore te punes. Kooperativat bujqesore e lidhin katundarin ekonomikisht me sektorin shtetnuer dhe i koordinojne Interesat e katundaris me interesin e pe bashkat te nderimit socialist te Vendit t'one.

Per te muejte me ia mbrrijte qellimit qe bujqesia te perparoje bashke me zhvillimin industrijal duhet te bah t lufte e vazhdueshme per ngritjen ne sasi dhe ne cilsi, per perdorimin e te gjitha masave agroteknike, veglave e maqinave moderne dhe per zbatimin e te gjitha masave te perpame me plan.

Detyra e kooperativave asht qe te perpiqen vazhdimisht per blemjen e veglave moderne teknike per perdorimin e tyne te perbashket, per krijimin e sektorvet te ndertimit, per perpunimin e prodhimeve e jo me u-kufizue vetem me shitblemjen e artikujve industrijale te konsumit te perditshem.

T'i çfrytzojme te gjitha burimet ekonomike lokale

Mandej e muer fjalen shoku Kadri Reufi, i Besuemi i Drejtorstit te punve komunale, i cili tha se me planin investicjonal te ketij vjeti jane parapa 33 per qind nga shuma e pergjithshme e investimeve per perparimin e ekonomis lokale ne Krahinen t'one. Ne projekt buxhetin e ketij vjeti nuk jane parapa kurrfare t'ardhunash nga sipermarrjet lokale te keshillave te rretheve e te qyteteve, per shkak se keto ende jane ne zhvillim e siper. Investimet e reja te ketij vjeti jane parapa per zgjanimin e sipermarrjeve te derbishme e sidomos t'atyne te tullave e te tjegullave, te cilat sivjet e kane planin e prodhimit 14 per qind ma te madh se sa ne vjetin e kaluem. Sivjet nuk jane parapa investime per bajen e sipermarrjeve te reja lokale, por kjo nuk do te thote qe keshillat popullore te mos zhvillojne ngultazi nji lufte te vashdueshme per çfrytezimin e te gjitha burimeve lokale, e sidomos te burimeve te qymyrit, sepse ky ndihmon shum industrin t'one, sipermarrjet e tullave e te tjegullave, prodhimin e gelqeres, e n'anen tjeter, ndikon shum n'uljen e shpenzimeve te prodhimit dhe ne kursimin e drave qe nevojiten aq shum per veprimtarin t'one botore. Keshillat popullore duhet te perpiqen vazhdimisht per çfrytezimin e kapacitetit te plote te maqinave, per ndamjen e drejte te fuqis puntore, per perdorimin racjonal te materjalit dhe per ngritjen e prodhimit ne sasi dhe cilsi.

Lufta kundra spekulimit asht lufte per jeten ma te mire te shtresave te gjana popullore

Shoku Sahit Zatriqi, i Besuemi i drejtoratit te tregtis, vuni ne dukje rolin dhe randesin e tregtis s'one socjaliste dhe suksesat e mbrrijtuna deritash ne sektorin e tregtis dhe tha se ne Krahinen t'one kemi 16 ndermarrje tregtare shtetnore nder rrethe dhe kater nder katunde, me 337 dyqane, prej te cilave 180 jane ne qytete e 157 ne katunde — Neper rrethe kemi Bashkimet kooperative e nder keshillat e vendeve kemi 468 kooperativa shit-blemse. Rrjeta e tregtis do te zgjanohet ne vjetin e dyte te Planit si ne sektorin shtetnuer ashtu edhe kooperativ. Deri tash jane ble 76.667.000 dinare malina te ndryshme prej te cilave jane shite 57.817.000 dinare. Tue fole per suksesat e mbrrijtuna ne sistemin e ri te furnizimit dhe te tregtis me çmimet e lidhuna tha se personat e marrun ne furnizimin e garantuem jane sigurue ne tremujorin e pare me tekstil 100 per qind, me yndyre 50 per qind me veshmbathje 100 per qind etj. Ne tregtin me çmimet e lidhuna jane ble 945.000 kg. mish, 2.710.871 kg. drithna, 400.445 kg. grushe, 14.463 kg. patate etj. Por me gjithe suksesat e mbrrijtuna jane konstatue edhe disa te meta si b fj. sherbimi informativ dhe evidenca ende nuk janë te knaqshme. Kredinat nuk perdoren me plan, sidomos ne sektorin kooperativ. Çfrytzimi me plan i kredinave ka randesi te madhe per zhvillimin e tregtis sepse, nga nji ane, shtohet kapitali qarkullues e, n'anen tjeter — me shitjen e shpejte te mallit te nevojshem per konsumuesit — fu nxohen shtresat ma te gjana te popullsis me artikuj te ndryshem industrijale, çka ndikon ne ngritjen sa ma te shpejte te standardit jetesuer te popullit t'one punonjes.

Para tregtis s'one shtrohet detyra e luftes se vashdueshme kundra spekulimit, sepse me luftue kundra spekulimit don me thane me luftue per ngritjen e standardit jetesuer te masave te gjana popullore, per zhvillimin ekonomik dhe per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one.

Pushteti populluer ne punen e tij gjithmonë duhet te mbeshtetet ne shtresat e gjana popullore

Referati i Pavle Joviqeviqit, sekretar i Kshillit Ekzekutiv Krahinuer per Kosmet

Mbasi u-aprovue llogarija perfundimtare e Keshillit Populluer Krahinuer te Kosmetit per vjetin 1946, Sekretari i Keshillit Krahinuer Pavle Joviqeviq, paraqiti referatin mbi punen e Keshillit prej mbledhjes se pare te Kuvendit deri me sot.

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer, prej kohes se Sesjoneve te fundit e ka vazhdue punen me hov ne kryemjen e detyrave qe i ka shtrue Plani pesvjeçar i Krahines s'one. Ne kete pikepamje jane korre sukese te mdha'a, me gjithe se ka pase dobesina dhe te meta organizative, mbi te cilat mendoj me fole ne fillim te ketij referati.

Mendoj, para se gjithash, me thane diçka mbi punet e keshillave t'ulta popullore, puna e te cilave asht shpreh ne punen e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer, sepse me te vertete zbatimi i vendimeve dhe direktivave te Keshillit Krahinuer, ne shumice, mvaret nga keshillat popullore te vendeve ase nga keshillat popullore te qyteteve e te rretheve dhe nga pjesmarrja e masave ne zgjidhjen e ketyne problemeve.

Suksesat t'ona, suksesat e organeve te pushtetit populluer t'arrijtuna ne dege te ndryshme te jetes ekonomike, kulturore e shoqnore te masave punonjese, e kane naltesue vetedijen dhe besimin e popullit ne forcat e tija, besimin se asht e mundun jo vetem me e realizue por edhe me e tejkalue Planin pesvjeçar. se Plani pesvjeçar, asht rruga ma e shkurte per ngritjen e fuqis se Vendit t'one, per likuidimin e mbrapambetjes se gjithaneshme te Kosmetit. Shqiptaret, serbet e malazezet jane binde, neper rezultatet e arrijtuna ne fushen e ndertimit, se puna e pushtetit populluer per realizimin e planit asht e drejte dhe ne te vertete perfaqeson aspiratat dhe tendencat e masave te gjana popullore. Ky asht ni element pozitiv qe deshmon se masat popullore po bashkohen per here ma fort rreth pushtetit te tyne populluer, se marrin pjese per here ma aktive ne punen e tij, se rritet karakteri demokratik i keshillave t'ona popullore. Masat po fillojne me e kontrollue dhe me e çmue ne mase per here ma te madhe dhe gjithnji ma te gjane punen e keshillave popullore, me dhane sugestionet dhe proponimet e tyne, me kritikue çdo gja qe nuk asht e mire. Ato po fillojne me u a lehtesue punen organeve te pushtetit populluer, me i marre si te vetat dhe me i zbatue me dashuni dhe vendosmeni per here ma te madhe udhezimet dhe urdhnat e pushtetit populluer. Ne ket pikepamje organizata e Frontit Populluer u ka dhane keshillave te pushtetit ndihme gjithnji ma te madhe.

Persa i perket karakterit demokratik, ne punen e keshillave popullore, simbas vezhgimit qe ka ba Keshilli Ekzekutiv Krahinuer, keto suksese jane arrijte ma teper atje ku keshilltaret e pushtetit ne terren e kane kuptue plotesisht detyren e keshilltarit te popullit dhe ku i kane aktivizue masat si duhet ne realizimin e dispozitave ligjore.

Por, nga ana tjeter, kemi nji numer jo te vogel keshillash e keshilltaresh te cilet harrojne se pushteti populluer ne punen e tij duhet te mbeshtetet gjithmone ne shtresat e gjana popullore. Atje, nder keto keshilla, ma pak ndigjohet zani i popullit, ma pak ndigjohet kritika popullore, atje ka keshilltare te cilet ende nuk e kane te kjarte koncepsjonin se ata jane sherbyesa te popullit, qe kane per detyre me i zbatue drejte dhe si duhet masat e pushtetit populluer. Ka edhe shum plogeshti, arbitrarizem e padije, shum mungese demokratizmi ne masa te ndryshme, bile edhe dashamirse te disa keshilltare. Kaloma keshilltare, sidomos neper katunde te cilet ne punen e tyne bijne nen influencen e dofare elementave te pasun spekulanta te katundit, qofte puna ne lidhje me blemjen e tepricave, ne lidhje me mbjelljet, me ndihmat sociale ase çfardo masash tjera. Por, n'anen tjeter, disa keshilltare ase keshilla ne terren, here here, ne lidhje me keto çashtje kthehen teper majtas, gja qe prap asht ne dam te punes dhe t'autoritetit te keshillave popullore. Keto te meta pak a shum burojne nga se shum keshilltare te popullit nuk jane mjaft te njoftun me randesin politike dhe me thelbin e punes se keshillave popullore, me ligjin mbi keshillat popullore, dhe nga se nuk i studjojne rranjesisht ligjet dhe dispozitat qe i nxjerrin organet eprore te pushtetit populluer. N'anen tjeter, ende nuk mbahen rregullisht mbledhjet e zgjedhsave, ne te cilat populli gjithmone duhet t'a çmoje punen e keshillave, ne çdo mbledhje te zgjedhsave t'a shprehe perseri besimin ase mosbesimin ndaj keshillit populluer, me ia parashtrue detyrat, e ma vone me e kontrollue kryemjen e tyne. Asht e vertete se ne ket periudhe jane mbajte mbledhjet e zgjedhsave ma shpesh se perpara. Por, asht gjithashtu e vertete se ne shum keshilla popullore te vendeve, keshilltaret izolohen nga kritika dhe diskutimet popullore, se shum mbledhje te zgjedhsave nuk pregatiten sa duhet, se ne to diskutojne vetem antaret e keshillit ekzekutiv populluer te vendit, se ne to nuk gjejne shprehjen e duhun inisjativa e njalle dhe proponimet e urta te popullit. Kuptohet se kjo gja rrenon ne aktivizimin e masave rreth pushtetit populluer, ne zhvillimin e demokracis s'one, se masat popullore, aty ketu, nuk e kuptojne plotesisht se masat e pushtetit jane interesa te vete turmave te gjana popullore. Ekziston edhe nji-fare botekuptimi i damshem se per dofare arsyena politike nuk u-dashka me lejue qe masat popullore t'a çmojne p'ol lirisht punen e pushtetit populluer, punen e ketij ase atij keshilltari, sepse, siç thone disa, kete mund t'a çfrytezojne disa elementa reakcjonare per te goife kundra keshillave dhe keshilltareve popullore. S'ka gja ma gabim se nji botekuptim i tille, mbrapa te cilit meshifet ne realitet frigа e keshilltarit te keq nga kritika e popullit e, n'anen tjeter, perpjekjet e anmikut qe masat e gjana popullore te mos aktivizohen ne lufte per t'a ndihmue zbatimin e masave te ndryshme te pushtetit populluer. Masat t'ona popullore si shqiptaret ashtu edhe serbet e malazezet jane binde tash ma teper se kurre, se te gjitha masat qe i ka zbatue pushteti populluer kane qene te drejta, kane qene te drejtueme ne forcimin e shtetit t'one, ne realizimin e Planit pesvjeçar te Titos, ne permirsimin e jetes se shtresave te gjana popullore, ne likuidimin e bash atyne elemntave reakcionare te cilet ne te kaluemen i çfrytezoishin dhe i shtypshin masat e gjana punonjese. Pra, per kete arsye populli puntuer i ka denue me sinqeritet te thelle te gjitha shpifjet e elementave reakcjonare kundra pushtetit populluer. Izolimi nga kritika popullore influencon negativisht edhe per arsye se çfaqet nji dukuni shum e damshme: aty ketu gabimet e nji keshillit populluer ase te nji keshilltari kritikohen mbas shpines se keshilltarit dhe keshillit, kritiken e ketyne te metave e perkrahin elementat e ndryshem, nuk e ndiejne keshilltaret e popullit, dhe per kete arsye, here here, edhe nuk i ndreqin gabimet e tyne — te gjitha keto shkojne jo ne dobi por ne dam te autoritetit te pushtetit populluer. Prandaj keshillave t'ona do t'u duhet me luftue qendrueshmenisht per demokratizmen e plote dhe per aktivizimin e masave ne punen e pushtetit.

Mungesa e demokratizmes ne punen e disa keshilltarve dhe keshillave influencon negativisht jo vetem ne jeten t'one politike, por edhe ne zhvillimin t'one ekonomik. Ne mbledhjet e zgjedhsave si dhe ne mbledhjet e ndryshme te popullit duhet te shprehet inisjativa ne te gjitha deget e punes se pushtetit. Me demokratizem te plote keshillat t'ona popullore kane muejte me i çfrytzue shum ma gjane te gjitha mundesinat lokale per zhvillimin e ekonomis. Kane muejte me u dhane organeve eprore te pushtetit populluer shum ma teper propozime e sugestione.

Por edhe kjo asht fakt, se organet eprore te pushtetit shtetnuer nuk kane marre nga poshte nji numer te madh propozimesh, jo sepse populli nuk ka se çka me propozue, ase sepse ekonomija lokale nuk ka kushtue per t'u zhvillue, por vetem nga shkaku se nuk asht punue mjaft n'aktivizimin e masave popullore ne ket drejtim.

N'anen tjeter, zbatimi jo i plote i shum masave te pushtetit populluer siç asht p. sh. urdhni i Keshillit Ekzekutiv mbi ndalimin e mjekimit antishkencuer, mandej shum raste te marteses primitive, poligamis etj., rrjedhin bash per shkak se persa i perket çashtjes se zbatimit te ligjeve dhe dispozitave nuk jane mobilizue dhe aktivizue te gjitha masat popullore.

As puna e mbrendeshme e disa keshillave nuk asht mjaft e rregullueme dhe e organizueme. Nuk mendoj vetem per veshtirsinat objektive ne pikpamje te mungeses se kuadrave dhe ne veprimtarin administrative, por ne rend te pare kemi raste qe ne shum keshilla te vendeve e gjithe puna e tyne bjen mbi kryetarin ase sekretarin, e shpesh here edhe ne nepunsin, e rralle mbi tane keshillin si tanesi, dhe se komisjonet dhe konsulat e qytetarve, si organe ndihmse te keshillit perkates populluer nuk i njofin detyrat te cilat duhet t'i kryejne; ne shum vende, ne vend qe t'aplikohen masat ligjore dhe dispozitat penale, te gjitha keto dispozita dhe ndeshkime zavendesohen me njifare bindjeje te bute dhe lutje, tue mos i zbatue mjetet ligjore te pushtetit. Mirepo, praktika na ka mesue se bash n'ato vende ku pushteti populluer ka veprue simbas ligjit vendosmenisht dhe me perkrahjen e masave, p. sh. karshi aty ne individve te cilet nuk i kane dergue femijte ne shkolle, populli i ka pranue keta hapa dhe e ka ndihmue pushtetin ne zbatim e ketyne masave dhe te tjera te ngjajshme.

Puna dhe udheheqja e paorganizueme e disa keshillave popullore, si edhe ne Keshillin Populluer Krahinuer, pasqyrohet edhe ne faktin se shum probleme nuk studjohen, se rezultatet e punes nuk çmohen thelle, se nuk nxjerret eksperienca nga puna, se nuk ndjeket vet procesi i kryemjes se njenes ase tjetres pune, e kjo shkakton qe te mos mundet me ndermjetsue me kohe. Per t'udheheqe me sukses nevojitet evidenca. E, gjaja qe karakterizon punen e mbare aparatit te pushtetit populluer, mund te themi lirisht qe prej keshillit te vendit deri ke Keshilli Ekzekutiv Krahinuer, asht evidenca shpesh here shum e dobet mbi te gjitha deget e punes s'one. Asht fakti se na ende nuk e kemi nji evidence t'atille, e cila ne çdo kohe mund te na e jape pasqyren e vertete te gjendjes se puneve, shpenzimit te kreditеve, shperndamjes se kuadrave, pasqyren e vertete te gjendjes se punve, shpenzimit te kerditeve, shperndamjes se kuadrave, pasqyren e vertete te gjendjes se qarkullimit dituer te mallnave ne tregti etj. Po ashtu qendron puna edhe me statistiken. Kur t'i kemi keto parasyshe e n'anen tjeter edhe perpjekjen e pamjaftueshme te drejtorateve te ndryshme te Keshillit Ekzekutiv Krahinuer per studimin e disa çashtjeve te ndryshme, a'here del e kjarte se ne pune nder deget e ndryeshme t'administrates shtetnore egzistojne mungesa te ndryshme. Ketu duhet me theksue posaçerisht shumicen e problemeve te sektoreve te politikes komunale dhe t'industris lokale komunikacjonit, bujqesis dhe prjeve tregtis etj. Gjendja dhe puna e ketille me doemos duhet te kete rrjedhime negative; prandaj nevojitet studimi i gjithanshem i problemeve, perdorimi i evidences dhe i statistikes se mire, e bashke me keto — perdorimi racjonal i te gjitha mjeteve ne dispozicjon, dhe zbatimi i kursimit sa ma te madh ne te gjitha deget. Mbassi jemi tue fole mbi te metat ke evidenca e planifikimit dhe ke menyra e udheheqjes, na duhet me permende se evidenca e jone asht posaçerisht e dobet ke shpenzimet e tregtis, se ke disa sipermarrje te rretheve e te qyteteve shpenzimet e tregtis ne fund te vjetit 1947 kane kape 20 % te vleftes se gjiros se kryeme dhe se shpenzimet posaçerisht te nalta ka pase fondi i rrogave, sepse personeli ne sektorin e tregtis asht shpenda dhe perdore pa plan. Ketu po e permendi edhe nji gja te dobet: te gjithe e dijne se rruget t'ona jane shum te dobta, gja qe kerkon pune te qendrueshme nga te gjitha keshillat popullore n'angazhim per meremetimin e rrugeve, si e si transporti i yne, i cili luen rol te madh ne kryemjen e Planit pesvjeçar, te kryhet sa ma mire e ma me sukses. Mirepo, me gjithese rruget t'ona jane aq te dobta, sa duhet me punue ne to nate e dite, prap se prap numri ma i madh i rojtareve te rruges nuk punon kurgja, ndersa nga ana tjeter arka shtetnore shpenzon per'ta sasina shum te mdhaja te hollash. Kesaj duhet me i dhane fund, sepse asht e mundun, tue marre parasyshe se per keto pune nuk nevojiten eksperta, por puntore te thjeshte e te mire.

T'a marrim mandej kujdesin shum te dobet mbi shperndamjen dhe perdorimin e kuadrave. Asht dukuni e perditshme qe keshillat popullore nuk i kushtojne kujdes te mjaftueshem aftesimit te njerezve dhe shperndamjes se tyne gja te cilen e verteton fakti se nji numer fare i vogel njerezish t'aftesuem ne kurs per dege ase pune te ndryeshme asht mbajte ne pune, te cilen e kane mesue. Asht rasti me ata qe kane krye kurse per marredhanje ne pune, per kujdestari, statistike, politike çmimesh, per ofiqare te gjendjes civile etj. Se sa mungon kuptimi dhe politika e drejte e kuadrave ne keshillat e ulta popullore, e verteton fakti se prej gjithe kursistave nga kursi i statistikes, te cilin e ka organizue kryesija e Qeveris se RPS, qe jane kthye nga ky kurs, vetem nji asht emnue ne detyren per te cilen asht aftesue. Politika e tille asht praktike e keqe dhe duhet me e ndalue.

Ka edhe shum dobesina dhe te meta te mdhaja ne te gjitha deget e administrates shtetnore ke te gjitha keshillat, por un do te flas mbi problemet dhe detyrat kryesore, te cilat i kemi zgjidhe mbrenda ketyne disa muejve te fundit, gjate se cilеs kohe jane mbrrijte sukseseе te dukshme dhe te randesishme. Te gjithe e dijne se bujqesija ke na asht dega ma e randesishme. Ne periudhen referuese edhe nji here kemi konstatue se asht i mundun planifikimi ne bujqesi dhe realizimi i ketyne planeve edhe ndaj qenjes se pronesis s'imte private, e cila e karakterizon katundin t'one. Ne mbjelljet e vjeshtes asht realizue dhe tejkalue plani i kulturave kryesore grunit, elbit e thekrес. Ka ngele mbrapa plani i mbjelljes se tershanes dimnore, i lluсerkes, terfojes dhe grozhezes, sepse mbjellja e vjeshtes e ketyne kulturave asht e re per bujqit t'anе. E organet e pushtetit nuk kane zhvillue lufte te qendrueshme per zbatimin e suksesshem te mbjelljes simbas kulturave. Per mbjelljet prandverore kemi qene deri diku ma te pregatitun, asht deshte te mbjellet me kultura prandverore 58 perqindja e siperfaqes se pergjithshme e tokes se punueme. Simbas planit asht deshte te mbjelle, tershane, bime per ushqim bagetish dhe perime ma shum se kurre deri tash. Pushteti populluer ka arrijte me organizue thyemien e kullosave dhe djerreve, dhe te negatise per mbjellje 5.876 hektare toke te re. Sikur rrethi i Rahoveсit, Vuçiternes, Prishtines e Gilanit t'ishin perpjeke edhe ma teper, plani i thyemies se djerreve dhe kullosave do t'ishte realizue jo 75%, por 100%. Ministria e bujqesis ne Republiken Popullore te Serbis na ka dhane ndihme te plote ne pikepamje te fares dhe prandaj kjo asht sigurue plotesisht. Por, n'anen tjeter, na kemi pase te meta t'atilla sa burimet lokale te fares se s'atermi nuk jane çfrytezue sa duhet. P. sh. kemi pare veshtiresina per mungese te fares se kononit ndersa kjo ka ndeite neper kooperativat e katundeve dhe ka mbete e pacfrytzueme per shkak te veprimit byrokratik dhe evidences se dobet per sasinat qe gjinden ne dispozicjon. Ka pase raste qe fara te bahet prej nji vendi ne nji tjeter, pa kurrfare plani etj.

Mund te konstatojme me knaqesi se, me gjithe kushtet mjaft te pa pershtatshme atmosferike, plani i mbjelljeve po realizoht me sukses dhe, simbas shenimeve te deritashme, egzistojne te gjitha kushtet se mbjelljet do te kryhen simbas planit. Para fillimit te mbjelljes prandverore, Keshilli Ekzekutiv Krahinuer muer vendimin mbi zbatimin e nji serie masash agroteknike aplikimi i te cilave do t'i sielle bujqesis dhe bujqeve pa tjeter dobina te mdhaja. Por keto masa nuk zbatohen plotsisht dhe kudo, prandaj para te gjitha keshillave qendrojne detyre te randesishme ne pikepamje te zbatimit te te gjitha ketyne masave per t'a shtue frytin e te gjitha degeve te bujqesis, siç e shtrojne detyret e Planit pesvjeçar. Na kemi mbrrijte me e angazhue katundarin qe ne ket vjet te thyej ma se 100.000 ha toke per mbjelljen prandverore, qe te n'uhnosi sasina te mdhaja farnash te kulturave prandverore etj. Kjo garanton frytin ma te mire. Por kjo nuk asht e tana. Ke na u asht kushtue kujdes shum i vogel luftetareve per fryt ma te madh. Drejtorati i bujqesis nuk disponon shenime te perpikta mbi numrin e luftetareve per fryt ma te madh. Fakti asht se ky numer nuk asht i mjaftueshem, e ne ne qendron detyre qe t'a nxitim mbare popullin ne lufte per produktivitet sa ma te madh. Ne kete lufte duhet te shkojme tue i bashkue kooperativat bujqesore per perparimin e bujqesis. Pushteti populluer ne t'ardhme duhet te perpiqet qe prane kooperativave bujqesore te formohen sektoret e bujqesis dhe keshillat bujqesore, te cilat do te prijne ne luften per prodhim ma te mire dhe do te kujdesen qe me ane te rruges kooperative t'i gjeje dhe te disponoje almiset bujqesore qe ndonji katundar, sidomos shtresa e varfen, nuk mundet me i ble me fuqit e veta. Mandej pushteti duhet te kujdeset qe kooperativat te formojne ekonominat e tyne, te kujdeset per kulturimin e katundareve ne sektorin e bujqesis, mbi shendetin e bagetive, mbi mprojtjen e pemve dhe te bimve nga dampruesat e ndryshem, mandej te kujdeset mbi perpunimin e frytevе te prodhueme bujqesore, te cilat derdhen pa kursim ne shum vende t'ona. Pa ket mase organizative, pa transfor-

(vazhdon ne faqen e katert)

Referati i shokut Pavle Jovigeviq

(vijon nga faqja e trete)

mimit e kooperativave te katundit n'organizata produktive bujqesore, as nuk mund te flitet mbi luften serjoze per aplikimin e masave agroteknike, per mekanizimin e bujqesis, per produktivitetin ma te madh ne katund. Derisa kooperativat te mos jene forcue si organizata bujqesore, bujqesija e jone do te çaloje dhe do te mbetet shum mbrapa industris, e kjo gja do ta rrezikonte realizimin e plote te Planit pesvjeçar jo vetem ne sektorin e bujqesis, por edhe ne sektorin e industris.

Sektori i yne shtetnuer ne bujqesi po rritet. Jane formue 11 ekonomina dhe institute bujqesore me karakter krahinuer, dy institute me karakter republikan dhe 13 ekonomina bujqesore me karakter rrethi e qyteti. Kjo rrjete e ekonominave bujqesore asht zgjanue mbrenda ketij vjetit prej 900 ne 3.000 hektare toke te punueme. Keto ekonomina po furnizohen me numer gjithnji ma te madh kafshesh seleksjonimi e pune, e gjate ketij vjetit prashiet ndertimi i objekteve n'institutet bujqesore ne nji vlefte prej 45.000.000 dinaresh.

Po shtohen gjithashtu edhe kooperativat bujqesore. Ne keto kooperativa bujqesore te punes jetojne afer 900 ekonomina me afer 5000 hektar toke. Ne ket periudhe asht formue edhe nji, dhe jane tue u-formue edhe kater kooperativa bujqesore te punes.

Ne Krahinen t'one pemet po rriten mire dhe, ne saje te angazhimit tre fish ma te mire t'organizatave masovike gjat ketij vjetit, kemi arrijte me e krye spastrimin mekanik ne 70 perqindjen e pemve.

Pushteti populluer ka ndihmue te ruhet shendeti i bagetive. Afer 85% te thundrakye jane vizitue me qellim te ndalimit te çfaqjes eventuale te semundjes duline. Asht ndermarre aksjon i madh per luftimin e zgjebes, dhe parashiet vakcionimi i afer 90.000 kreneve bageti te trasha kundra antraksit.

Nji siperfaqe e madhe e pyjeve komunale simbas ligjit asht ba pasuni e shtetit, veç kesaj nen drejtorin krahinore kemi edhe pyjet e Neredimljes. Jane formue pese fidanishte te reja per te prodhue sa ma shum fidane per pyllezim. Plani i pyllezimit prandveruer asht realizue plotsisht, ndersa plani i meljoracjonit te rrahishtave asht realizue me 148%.

Ne degen bujqesore shtrohen detyre te mdhaja para nesh jo vetem ne pikepamje te shtimit te prodhimit ne bujqesi, por edhe ne pikepamje te studimit dhe organizimit te zhvillimit t'atyne degeve te bujqesis, per te cilat ka kushte te mjaftueshme, si p. sh. rritja e krymbave te mendafshit, rritja e bletve etj.

Perpjekjet t'ona kane qene te mdhaja edhe ne sektorin e tregetis. Me hymjen e rregulloreve te reja ne fuqi mbi tregetin me çmimet e lidhuna dhe mbi furnizimin e garantuem, asht permiresue shum furnizimi i katundit me prodhime industrijale dhe i qytetit me gjanat ushqimore. Lidhija ndermjet qytetit e katundit asht forcue bukur mire.

Me hymjen ne fuqi te Dekret-ligjit mbi çmimet e lidhuna na asht deshte me e ndryshue pak planin e zhvillimit te rrjetes s'one tregtare dhe me u-orjentue ne zhvillimin ma te shpejte t'aparatit tregetar per organizatat kooperative. Ne ket pikepamje kemi korre sukses te konsiderueshme. Jane organizue seksjonet e blemjes prane bashkimeve te kooperativave te rretheve. Numri i dyqaneve shtetese asht shtue prej 239 ne 342, e numri i dyqaneve kooperative prej 450 ne 485. Nji numer i dyqaneve shtetnore u asht dorezue kooperativave shit-blerse te vendeve. Jane hape edhe 103 tregtore te sipermarrjeve shtetnore ne kasaba. Hapja e ketyne dyqaneve asht ne lidhje me pregatitjet t'ona per organizimin e rrjetes edhe ma te gjane tregetare te shtetit, e cila do t'i zavendesoje mbeturinat e tregetis private. Asht e dijtun se ke na, ne sektorin e tregetis private, nuk ndihet kurrfare veprimtarije serjoze tregetare, se dyqanet private tregtare jane ba vende kontrabande, spekulimi dhe shtimi te paligjueshem te çmimeve, shpesh here edhe per ato malla te cilat i blejne tregtaret private ne menyrna te ndryshme nga magazinat shtetnore, per t'i shite ma vone ne menyr te palejueshme me çmime te nalta. Per ket arsye e u-inicue te shtresave te gjana puntore na duhet me iu perveshe likuidimit te vendosun te sane tregtis private.

Asht ba nji hap i madh perpara ne pikepamje te ngritjes se kuadrit profesjonal tregtar. Kemi organizue kurse gjashtmujore per ndihmesa ekonomike tregtare, ne te cilat jane afersue 538 vete, mandej kursin e kontabilitetit te njiformite, ne te cilin jane afersue 50 vete, kurse katermuejshe per puntore te praktikumit, ne te cilat jane afersue 130 vete, kater kurse gjashtmujore per puntore te praktikuem me 143 kursista, dhe 3 kurse per administratore kooperativash me 83 ndjeksa. Keshtu rrjeta e jone tregtare asht plotesue me kuadra te reja, te cilat do te dijne me e zhvillue tregtin e kulturueme. Neve na asht deshte ma e realizue ket detyre, e edhe tash e tutje do te punojme ne ket drejtim, mbassi n'aparatin t'one tregtar gjindet nji numer i madh ish tregtaresh dhe elementash te ndryeshem spekulanta me botekuptime dhe shprehina te vjetra, te cilat ndikojne negativisht ne tregtin t'one dhe prandaj keta duhet t'i qesim pa kurrfare meshire nga aparati i yne tregtar.

Katundarija puntore i ka prite me kenaqesi te madhe Dekret-ligjet e reja mbi çmimet e lidhuna, gja e cila shifet edhe nga rezultatet qe ka korre tregtija me çmimet e lidhuna. Plani i blemjes se drithnave asht realizue qind per qind, e plani i blemjes se bageve asht tejkalue. Ndaj tregtis me çmimet e lidhuna, para nesh shtrohet tash detyra e blemjes se detyrueshme te leshit e mishit. Ky plan asht pergatitue per çdo rreth, e tash shtrohet si detyre perpunimi i planeve per çdo keshill vendi dhe mandej per çdo familje. Me kete rast duhet pase parasyshe se ne caktimet e perparshme per ekonominat e ndryeshme ka pase gabime. Prandaj duhet qe me rastin e kesaj blemjeje te kujdesemi me e krye detyrimin ne menyre progresive. Kjo do te mundet me u-krye vetem atehere, ne qofte se do t'a kemi pasqyren e perpiket te numrit te bagtive qe ka çdo familje veç e veç. Per kete arsye, keshillat popullore te vendeve, me ndihmen e plote te keshillave te rretheve duhet t'i pervishen urgjentsisht kesaj pune, sepse nga e gjithe kjo mvaret kryemja e suksesshme dhe e drejte e blemjes.

Ne tregtin me çmimet e lidhuna ka pase nji varg te metash qe pasqyrohen ne kujdesin e pamjaftueshem mbi llojin e mallit qe porositet. Nuk jane raste te rralla, ku aparati i yne tregtar nuk asht bazue ne nevojat e popullit kur asht porosite malli industrijal. Asht e dijtun se katundaret ende nuk mund te gjejne sa duhet almise bujqesore me çmime te lidhuna, me gjithe se keto sot i nevojiten ma se teperni. Veç kesaj, jane raste te shpeshta qe asht porosite per shitje me çmime te lidhuna shum ma pak malle industrijal se sa asht nevojite ne te vertete. Prej kendej kane rrjedhe edhe pasojat e furnizimit te pamjaftueshem te katundaris me mallin perkates.

N'anen tjeter, shpenzimet e udhtimeve rreth gjetjes se mallit kane qene ma te mdha se sa fitimet qe duhet t'i nxjerrshin kooperativat per t'i mbulue shpenzimet e rrethis. Edhe ktu shifet se sa e nevojshme asht qe keshillat popullore ne punen e tyne te mbeshteten ne ndihmen dhe pjesemarrjen e shtresave te gjana popullore. Persa i perket blemjes se detyrueshme, ka randesi te theksohet se edhe ndaj korrjes se begateshme te vjitit te kaluem, blemja e drithit asht krye vetem per 94.5%, e, plani i sasinave te kontraktueme lirisht per 85,7%, ndersa plani i pasulit asht krye per 102%. Te gjitha keto flasin se keshillat popullore nuk jane angazhue sa duhet, prandaj me njihere duhet t'i marrim te gjitha masat e duhuna per realizimin e plote te planit te blemjes, bile sa ma pare, kesaitu qe me kohe te kryhen pregatitjet e nevojshme, per mbledhjen e ketij vjeti.

Krahas me zhvillimin e drejte te blemjes me çmime te lidhuna asht permiresue edhe furnizimi i popullsis s'one puntore. Furnizimi i popullsis, e cila asht e sigurueme me ate te garantuem asht krye keshtu: me tekstil e veshmbathje 100%, me buke 100%, me sheqer, kakao, kafe, oriz e grize 100%, me yndyrna 90% dhe me mish 50%. Ky asht perparim i madh ne krahasim me muejin fruer te ketij vjeti dhe ka ardhe si pasoje e suksesevet t'ona te mdhaja ne tregtin me çmimet e lidhuna. Por, ky furnizim jo i plote me yndyrna e mish as se aferm nuk na kenaqe, e ne t'ardhme mund te permiresohet, ne qofte se e kryejme me kohe planin e blemjes se kashteve.

Dekret-ligji mbi furnizimin e garantuem ka kulluencue pozitivisht n'ekonomin t'one edhe ne pikepamje t'inkuadrimit te njerezve ne punc, te cilet nuk kane qene t'inkuadruem n'ekonomi, gja qe shifet nga kjo: ne fruer kemi pase 21.032 puntor dhe 103.437 qytetare ne furnizim te garantuem, e ne mejin prill ky numer asht shtue ne 37.120 burra e gra te siguruem me triskat "R", ndersa numri i qytetareve te siguruem me triskat "O" asht ule ne 95.165. Gjashtedhjete e pese perqindja e konsumuesave te permendun jane popullsia e qytetit, e 35% te katundit. Por, edhe ketu ka shum shmangeje djathtas ase majtas. P. Sh. neper katunde, e ma rralle neper qytete, ... te mesme ekonomike, kush e dis se

ne çfare menyre, kane marre triskat e furnizimit te garantuem, e nga ana tjeter, ka familje te vorfuna neper katunde, e aty ketu edhe mesuesa, qe nuk jane marre me furnizimin e garantuem. Keto gabime, sado t'inta te duken, shpesh here jane ba me qellim prej disa keshilltareve inkoshjenta te keshillave popullore te vendeve, te cilet ia kane lane ket pune nepunesit. Keto gabime kane pasoja te damshme dhe damtojne autoritetin e pushtetit populluer si dhe shtresat e vorfuna.

Persa i perket evidences dhe planifikimit ne tregti, mund te thuhet se kjo asht shum e parregullueme. Shpesh here keshillat popullore nuk angazhojne persona per mbajtjen e evidences dhe sherbimit informativ.

Lufta kundra spekulantave te qytetit e te katundit ka qene shum e dobet, e kjo shifet nga fakti se prej nji numerit te madh spekulantash, vetem 12 vete u jane dorezue prokurorive publike.

Keshillat popullore, gadi ne te gjitha vendet i kane kushtue kujdes te dobet ushqimit shoqnuer. Gadi neper te gjitha menzat t'ona per puntore e nepunesa, shpesh here, ushqimi asht i dobet. Edhe ket çashtje, keshillat popullore ne t'ardhme duhet t'a shqyrtojne dhe t'a zgjidhin ma serjozisht, e kjo don te thote me kontrollue ma teper drejtorinat e menzave dhe te hoteleve, tue mos lejue qe e tane puna te zhvillohet simbas deshires se kujdo qe gjindet ne pune prane sipermarrjeve perkatese.

Veprimtarija e jone botore, para se ciles paraqiten detyre shum te mdhaja, sidomos ne ndertimin kapital, si dhe n'objekte te ndryeshme te ndertimit, asht permiresue shum. Sipermarrjet e ndertimeve iu kane perballue kushteve te pa-knaqeshme te punes gjate vjetit te kaluem. Ne vjetin e kaluem kemi pase mungesa dhe nuk kemi pase kurrfare rezervash materjali kryesor te ndertimeve: tulla, bekur dhe lande druni. Mjetet e transportit kane qene te dobta. Planet dhe elaboratet per shumicen e objekteve kane ardhe jo te plota dhe me vonesa te mdhaja, keshtu qe punet te cilat i kemi fillue vone, shpesh here jemi detyrue me i nderpre.

Mekanizimi i punve botore nuk ka egzistue fare. Kuadrat e evidences kane qene te padije dhe mjaft te dobta. Puna e disa sipermarrjeve nuk asht zhvillue rregullisht simbas planit, por shpesh here ne menyre stihike. Kontrolli i punes ka qene i pamjaftueshem. Menyra e re e muratimit nuk ka marre hov te plote si sistem i vazhdueshem i punes ne te gjitha objektet e ndertimit. Gara ndermjet objekteve te ndryeshme te ndertimit ka qene, te thuesh, e paforme. Drejtorati i Puneve Botore nuk ka qene mjaft operativ dhe nuk ka pase personel profesjonal per t'iu dhane sipermarrjeve me kohe nevojen e duhun. Por me perpjekjet e qindrueshme te Keshillit Ekzekutiv dhe te drejtorave kemi arrijte qe nji pjese te veshtiresinave t'i zotnojme dhe eliminojme. Kjo ka kontribue shum qe sipermarrjet e ndertimeve t'a realizojne detyren me plan per 93%.

Gjate perjudhes se dimnit disa pune jane vazhdue pjeserisht, e veç kesaj, sipermarrjet e ndertimeve kane punue n'aftesimin dhe ngritjen e kuadrave profesjonale. Suksesiet ne ngritjen e kuadrave nuk kane qene ashtu si i kerkojne detyrat qe shtrohen para nesh, sepse gjate perjudhes se dimnit jane aftesue vetem 66 kryepuntore, 47 murator, 12 beton-armista, 15 gdhendesa dhe 36 evidentista, kurse nevojiten shum ma teper.

Gjate kesaj perjudhe jane krye disa objekte te vjetit te kaluem, siç jane shkolla bujqesore, institut i sigurimit social, fabrika e tullave dhe e tjegullave, objektet bujqesore ne Prishtine, fabrika e prodhimeve te llamarines, punetorija e shkolles se mesme teknike ndertesa e sindikatit ne Mitrovice, ndertesat e paragjimnazeve, ambulantave dhe seksjonit te mbrendeshem, mullijt ne Serbice e Fushe-Kosove, magazinat e drithit dhe qumshtorija ne Peje, garazha e traktorave, fabrika e tullave ne Peje, shkolla pedagogjike ne Gjakove etj. Ne te gjitha keto objekte punet po marrin fund, por mungon materjali elektrik e ujesjelles.

Kemi fillue edhe objekte te reja ndertimi: blokun e ri te banesave ne Prishtine, fabriken e shpee-pllakave, fabriken e mobiljeve, pavijonet ne banjen e Pejes, spitalin anti-tuberkular ne Peje dhe objekte te ndryeshme bujqesore. I kane materjali i duhun per te gjitha objektet e randesishme asht sjelle ne vendet e ndertimit me perjashtim te derrasa dhe tullave, gja qe e veshtiresoj zhvillimin e shpejte te ndertimit.

Ne perjudhen qe po vjen, dmth. gjate ketij vjetit, na presin pune te mdhaja ne sektorin e ndertimeve. Vlera e pergjithshme e puneve investicjonale prej 372.924.081 dinare, dmth. detyra e planit asht ma e madhe se

ajo e vjetit te kaluem per 47%. Ndaj kesaj kemi nji veprimtari intensive ndertimesh ne katund, ku po ndertohen 200 shtepija kooperative. Detyra kaq e madhe na detyron me i forcue sipermarrjet t'ona organizativisht, me zbatue kursimin serjoz, evidencen, kontrollin dhe pergjegjesin ne te gjithe ndertuesat, tue fillue prej kryepuntorit ne vendin e punimit deri ke drejtori i sipermarrjes. Nga ana tjeter do te na duhet te bazohemi ne mase te plote, shum ma teper se ne vjetin e kaluem, ne hovin punonjes te shtresave te gjana popullore, te kerkojme prej tyne ndihmen e plote si ne çashtjen e ndihmes me pune vullnetare ashtu edhe ne çashtjen e gjetjes se puntoreve te ndertimit qe gjinden akoma ne Krahinen t'one. Pergjegjesi e posaçme u takon ingjinjerave t'one. Secili prej tyne duhet t'udheheqe ne sipermarrje me nji ndertim te gjane mesatarisht 50 miljona dinare, e veç kesaj me u dhane ndihme edhe ndertuesave te shtepijave kooperative. Ma ne fund ka me u-dashte me organizue punen ma mire ne puntorinat t'ona zejtare, keshtu qe te munden me iu pergjegje detyres ne lidhje me degen e ndertimit.

Tash diçka mbi arsimin:

T'udhehequn me parimin se kultura dhe arsimi duhet te bahet pasuni e shtresave te gjana popullore, se analfabetet t'one duhet t'i nxjerrim nga errsina e injorances, e nga ana tjeter, tue u-kujdese ne rend te pare mbi ngritjen kulturo-arsimore te masave shqiptare, pushteti populluer ka bo hapa te mdhaj perpara ne fushen kulturo-arsimore.

Asht fakti se ne pikpamje te shkollimit, ne muejin nanduer te vjetit te kaluem kemi pase si ustenje paknaqshme. Prej 247 shkollave serbe—58 kane qene boshe per mungese mesuesash. Prej 273 shkollave shqipe—32 s'kan punue. Prej 34247 nxanesve serbe shkollen e kane ndjeke vetem 24.595 nxanes, e prej afer 50.000 nxanesve shqiptare, shkollen e kane ndjeke gjithsejt 17421 nxanesa. Per t'a kuptue kete si duhet, duhet me pase parasyshe se situata e ketille e gjendja e ketille na çojshin kah rritja e analfabetve te ri, e keshtu edhe kah moskryemja e planit t'one n'arsim.

Prandaj Keshilli Ekzekutiv, me ndihmen e qeveris se Republikes Popullore te Serbis, ka vendose me iu perveshe shpejt dhe vendosmenisht zgjidhjes se kesaj çashtjeje. Si rezultat i masave te marruna kemi hape 106 shkolla shqipe dhe 31 shkolla serbe, e keshtu sot kemi 379 shkolla fillore shqipe dhe 278 shkolla fillore serbe. Ne keto shkolla punojne 841 klase shqiptare dhe 666 serbe, me 58665 nxanesa shqiptare dhe 35629 nxanesa serbe, prej te cilve, gjate muejit prill kane ndjeke shkollen 42657 shqiptare dhe 32754 serbe e malazeze. Pra, numri i nxaneve te cilet e ndjekin shkollen shqipe asht rrite ne 72,7% e i nxanesve qe ndjekin shkollen serbe ne 92%. Ky sukses do te kishte mujte me qene shum ma i madh sikur te kishte pase intervence energjike dhe me kohe nga ana e organeve inferjore te pushtetit, d. m. th. sikur t'ishin perpjeke me te gjitha mjetet per t'a zbatue vendimin e Keshillit Ekzekutiv Krahinuer. Problemin e mesuesave per keto shkolla e kemi zgjidhe keshtu: prej rradheve te puntoreve e katundarve shpesh here edhe me nga kater klase fillore, kemi marre nji numer njerzish, sidomos shqiptare, dhe

i kemi emnue per mesuesa. Keta ma vone do t'aftesohen neper kurret pedagogjike. Keshtu sot kemi 445 mesuesa shqiptare dhe 326 mesuesa serbe.

Ne pikpamje te paragjimnazeve: ne muejin nanduer kemi pase 12 paragjimnaze shqiptare, ndersa sot kemi 14, kemi pase 11 paragjimnaze serbe, e sot kemi 13. Plani i regjistrimit ne gjimnaze asht plotesue. Ne fillim te kalendorit jane formue klase te reja se para prane gjimnazeve shqiptare, ne te cilat jane regjistrue 200 nxanesa ma te mire te klases se katerte te shkolles fillore. Plani i regjistrimit te serbve ne shkollen pedagogjike asht plotesue, ndersa ne shkollen pedagogjike shqiptare jo, sepse nuk ka pase mjaft nxanes me semimature te kryeme.

Dy probleme jane shum te randesishme, dhe mund te thuhet se jane vendimtare ne lidhje me çashtjen e shkollimit. E para, sigurimi i lokaleve shkollore qe jane ma teper se te ngushta per numrin e nxanesve qe kemi, e aq ma teper kur ta marrim parasyshe numrin e nxanave qe do te regjistrohen ne vjetin e ardhshem shkolluer. Nuk asht i vogel numri i shkollave te vendosuna ne shtepija shum te mjerueshme te katundit. Prandaj, duhet me i kushtue kujdes te plote ndertimit te godinave te reja shkollore edhe neper katunde edhe neper qytete. E dyta, kuadri i mesuesave asht akoma mjaft i vogel dhe pa dijeni te mjaftueshme profesjonale, sidomos ke shqiptaret, e prandaj duhet t'i kushtohet kujdes i plote ngritjes se nivelit profesjonal te kuadrit mesimuer. Ma ne fund kujdesi i pushtetit populluer rreth sigurimit te ndertesave sa ma te mira per shkollat shqipe mandej sigurimi i materjalit te shkollave dhe i mesuesave, mbassi organet e ulta te pushtetit populluer shpesh here e zgjidhin kete çashtje sipertaqesisht e pjeserisht, ase nuk e zgjidhin fare. Ketu duhet me e kerkue ndihmen e shtresave te gjana popullore, te cilat shum e shum here deri tash e kane ndihmue pushtetin ne zgjidhjen e çashtjeve te komplikueme arsimore etj. Gjate periudhes se kalueme masa te reja burrash e grash kane mesue shkrim e kendim. Kane mesue shkrim e kendim 36.236 vete prej te cilve 16.545 jane shqiptar dhe 6791 shqiptare. Ky sukses asht relativisht i pamjaftueshem sepse ne kurse kemi pase 77.517 veta. Don me thane se ma se 40.000 burra e gra na kane rreshite nga kurse, kryesisht nga shkaku se fushata asht organizue vone. Randesi te madhe ka organizimi i kurseve t'ulta arsimore per ata qe kane mesue shkrim e kendim, tue angazhue ne kete pune rinin e shkollave te mesme dhe kuadrin tjeter kulturoarsimuer. Me ata ndjeksa te kurseve qe nuk e kane krye provimin, e sidomos me shqiptar gjate veres duhet me e vazhdue punen ne kurse".

Mbasi vuni ne dukje rezultatet e mira ne kurset arsimore si dhe pasunimin e bibliotekave me libra shoku Pavle tha se duhet t'i japim nji kujdes te veçant botimit te sa ma shum librave per shkollat shqipe.

Ma ne fund tue e perfundue referatin e vet shoku Pavle tha se keshillat popullore duhet te perpiqen me gjete sa ma shum puntor per sipermarrjet t'ona, mbassi ne krahinen t'one ka mjaft rezerva fuqish te pashfrytzueme puntore, si dhe me u-perpjeke per luftimin e epidemive dhe smundjeve ngjitse per te ruejt sa ma mire shendetin e popullit.

Qeverija popullore e Serbis asht e vendosun me e ndihmue me te gjitha forcat e veta Kosmetin

— tha ministri Mehmet Hoxha

Mbas referatit u-zhvillue diskutimi i gjane. I pari e muer fjalen deputeti Mehmet Hoxha, minister i minierave ne qeverin e Republikes Popullore te Serbis.

Mbassi pershendeti perfaqesuesat dhe popull e Kosmetit n'emen te qeveris se Serbis, ministri Hoxha, tue analizue punen e pushtetit ne baze te referatevet e diskutimit, konstatoi nder te tjera se pushteti populluer, me gjithe gabimet e te metat qe sune çfaqe aty ketu, ka korre sukses shum te mdhaja ne te gjitha fushat e veprimtaris.

Mandej foli mbi perpjekjet e mdhaja qe baine populli e Kosmetit per realizimin e detyrave te vjetit te dyte te Planit pesvjeçar, si pjese perbase te perpjekjeve qe baine te gjithe populli e Jugosllavis dhe tha: „Qeverija popullore e Serbis i çmon perpjekjet e popullit te Kosmetit dhe punen e pushtetit populluer dhe asht plotesisht e vendosun qe, si deri tash ashtu edhe ne t'ardhmen me e ndihmue edhe ma teper Krahinen e Kosmetit me te gjitha mjetet qe ka, per te dale sa ma pare nga mbrapambetunija ekonomike e kulturore. Kosmeti i ka te gjitha kushtet per te perparue me hapa te mdhaj, dhe ka me perparue".

Mandej moren pjese ne diskutim deputetet: Aluah Zariq, Tahosva Rosiq, Millosh Vlodrovtq dhe mjaft te tjere prej rretheve te ndryshme.

Mandej Keshilli Populluer Krahinuer aprovoi unanimisht propozimet qe do t'i dergohen per aprovim Kuvendit Popullor te RP te Serbis mbi disa ndryshime administrativo-teritoriale te keshillave te vendeve si dhe vendone per themelimin e drejtorinave krahinore te pyjeve (Prishtine, Ferizaj, Gilan, Mitrovice e Prizren), farmes bujqesore krahinore (Dushanove), stacionit per rritjen e shpendeve e te bletve (Deçan), stacionit modelor regjional te bujqesis (Sllatine e Eperme). Stacjonet bujqesore te rretheve Ferizaj, Gjakove, Rahovec, Mitrovice dhe Dushanove, qe deri tash kane pase karakter rrethi, do te bene karakter krahinuer. Formohet sipermarria Krahinore e instalimeve dhe montimeve ne Prishtine, sipermarrja krahinore per eksploatimin dhe shfrytezimin e gurit per mullij ne Mitrovice, sipermarria krahinore per eksploatimin e gurit ne Peje, sipermarria krahinore per eksploatimin dhe perpunimin e drunit ne Ferizaj, sipermarrja krahinore e tulleve ne Peje, stacjoni sanitar epidemiologjik ne Gilan, Instituti sanitar epidemiologjik ne Prishtine, sipermarrja krahinore e grumbullimit dhe furnizimit ne Prishtine. Te gjithe ujnat e Kosmetit, ne te cilat peshkohet, shpalloen pasuni e pergjithshme shtetnore. Keshilli Popullor Krahinuer i ngarkoi keshillat e rretheve te formojne kooperativat peshkatare, afer ku egzistojne kushtet objektive, dhe te hartojne planet vjetore te peshkimit.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor — Shtypshkroja Krahinore e Frontit popullor
Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.